



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

[www.qbz.gov.al](http://www.qbz.gov.al)

**Nr.175**

**dhjetor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Dekret nr. 7863 datë 20.12.2012	Për lirim ambasadori nga detyra.....	10491
Dekret nr. 7864 datë 20.12.2012	Për lirim ambasadori nga detyra.....	10491
Dekret nr. 7865 datë 20.12.2012	Për lirim ambasadori nga detyra.....	10492
Dekret nr. 7867 datë 20.12.2012	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10492
Dekret nr. 7868 datë 20.12.2012	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10493
Dekret nr. 7871 datë 20.12.2012	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10493
Dekret nr. 7872 datë 24.12.2012	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	10494
Dekret nr. 7893 datë 27.12.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	10494
Dekret nr. 7894 datë 27.12.2012	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	10495
Dekret nr. 7895 datë 27.12.2012	Për emërim ambasadori në detyrë.....	10496

Vendim i GJK nr. 56, datë 21.12.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 167, datë 19.1.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.....	10496
Vendim i GJK nr. 57, datë 21.12.2012	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve: nr. 109, datë 14.8.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 85, datë 17.3.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2010-766-540, datë 26.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; Dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.....	10501
Vendim i GJK nr. 58, datë 24.12.2012	Me objekt shfuqizimin, si antikushtetues, të vendimit nr.31, datë 31.1.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit); vendimit nr. 933, datë 17.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr.631, datë 13.11.2009 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.....	10513
Vendim i GJK nr. 59, datë 24.12.2012	Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë, brenda afatit të arsyeshëm, nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.....	10527
Vendim i KMDHP nr. 4, datë 27.12.2012	Për përcaktimin e rasteve për përjashtimet nga detyrimi për njoftimin e të dhënave personale, që përpunohen.....	10532
Vendim i KMDHP nr. 5, datë 27.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 2, datë 10.3.2010 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre”.....	10533
Udhëzim i KMDHP nr. 24, datë 27.12.2012	Për detyrimet e kontrolluesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale.....	10534
Udhëzim i KMDHP nr. 25, datë 27.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 6.9.2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere”.....	10535
Udhëzim i KMDHP nr. 26, datë 27.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 4, datë 16.3.2010 “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”.....	10536
Udhëzim i KMDHP nr. 27, datë 27.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 7, datë 9.6.2010 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit”.....	10537

Udhëzim i KMDHP nr. 28, datë 27.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 11, datë 8.9.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” .....	10538
Udhëzim i KMDHP nr. 29, datë 27.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 26.12.2011 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë” .....	10539
Udhëzim i KMDHP nr. 30, datë 27.12.2012	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 19, datë 3.8.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” .....	10539
Udhëzim i KMDHP nr. 31, datë 27.12.2012	Për përcaktimin e kushteve dhe kritereve për përjashtimin nga detyrimet përkatëse në përpunimin e të dhënave personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike.....	10540
Udhëzim i KMDHP nr. 32, datë 27.12.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 9, datë 15.9.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive” .....	10542

**DEKRET**  
**Nr. 7863, datë 20.12.2012**

**PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Ylljet Aliçka lirohet nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Francës, rezident, si dhe nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Principatën e Monakos, jorezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7864, datë 20.12.2012**

**PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Altin Kodra lirohet nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë, rezident, si dhe nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Republikën e Azerbajxhanit, në Republikën Islamike të Iranit, Republikën e Kirkistanit, Republikën Islamike të Pakistanit dhe në Republikën e Gjeorgjisë, jorezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**



**DEKRET**  
**Nr. 7865, datë 20.12.2012**

**PËR LIRIM AMBASADORI NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Admirim Banaj lirohet nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Arabisë Saudite, rezident, si dhe nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë të Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bahreinit, në Sulltanatin e Omanit, në Kuvajt dhe në Republikën e Jemenit, jorezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7867, datë 20.12.2012**

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Dritan Tola emërohet ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Francës, rezident, si dhe ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Principatën e Monakos, jorezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7868, datë 20.12.2012**

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Kujtim Morina emërohet ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Shtetin e Kuvajtit, rezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7871, datë 20.12.2012**

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Mal Berisha emërohet ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe, rezident, si dhe ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqiptotë i Republikës së Shqipërisë në Irlandë, jorezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**



**DEKRET**  
**Nr. 7872, datë 24.12.2012**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, të neneve 20 dhe 24 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Guri Kristo Puja
2. Dhimitrulla Stavro Puja
3. Vasfi Beqir Sino
4. Blerti Vasfi Sino
5. Dhimitra Pandeli Kordha
6. Mira Refat Lamçe
7. Sofie Vangjel Dashi
8. Koço Jorgaq Dhimitri

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7893, datë 27.12.2012**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                 |                                   |
|---------------------------------|-----------------------------------|
| 1. Mimoza Safet Bajraktari      | 14. Holta Fatos Dürschmid (Plaku) |
| 2. Romir Ilir Kavaja            | 15. Arlind Luan Muçaku            |
| 3. Armir Arben Shaplo           | 16. Mirela Tom Kuhn (Curri)       |
| 4. Albana Marsi Tahiraj (Gremi) | 17. Nasho Emond Pinguli           |
| 5. Claudia Agim Tahiraj         | 18. Durim Murat Bani              |
| 6. Denisa Agim Tahiraj          | 19. Ekleva Mitat Bani (Mebelli)   |
| 7. Vasiliki Georgios Katsifi    | 20. Klea Pellumb Shuli            |

- |                                     |                                     |
|-------------------------------------|-------------------------------------|
| 8. Sirjus Kujtim Iljazi             | 21. Michael Esat Gega               |
| 9. Alban Resmi Bregasi              | 22. Nevila Mukadez Asoviç (Ramja)   |
| 10. Adrian Ahmet Shabani            | 23. Valbona Petrit Okoro (Çollaku)  |
| 11. Saimir Rustem Kortoci (Kortoci) | 24. Vjollca Skënder Haçkaj (Hackaj) |
| 12. Bernard Viktor Gjokthomi        | 25. Enida Fiqiri Ramasaço (Reçi)    |
| 13. Esmeralda Muharrem Benz (Kurti) |                                     |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**

**DEKRET**  
**Nr. 7894, datë 27.12.2012**

**PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimin e Ministrisë të Brendshëm,

**DEKRETOJ:**

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- |                                   |   |
|-----------------------------------|---|
| 1. Brunilda Skënder Pitani        | 10. Bardhyl Maliq Balaj                 |
| 2. Arbër Ilir Qesja               | 11. Valdete Hajredin Balaj (Coro)       |
| 3. Përparim Ali Simoni            | 12. Blerina Skënder Gjoka (Memishi)     |
| 4. Selina Përparim Simoni         | 13. Edi Nikolla Ogreni                  |
| 5. Aron Përparim Simoni           | 14. Enkelejda Kristul Deda (Cani)       |
| 6. Edmond Hamdi Topi              | 15. Enxhi Beatrice (Beatrice) Koço Deda |
| 7. Rubin Sadri Ahmeti             | 16. Afërdita Kadri Golbach (Elezi)      |
| 8. Erenik Binak Çelaj             | 17. Sadik Xhemal Gjata                  |
| 9. Jurilda Petraq Kaçeli (Kaceli) | 18. Roland Sadik Gjata                  |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
**Bujar Nishani**





**DEKRET**  
**Nr. 7895, datë 27.12.2012**

**PËR EMËRIM AMBASADORI NË DETYRË**

Në mbështetje të nenit 92, shkronja “dh” dhe 93 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

**DEKRETOJ:**

**Neni 1**

Zoti Genc Muça emërohet ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Turqisë, rezident, si dhe ambasador i Jashtëzakonshëm dhe Fuqplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Azerbajxhanit, në Republikën Islamike të Iranit, Republikën e Kirikistanit, Republikën Islamike të Pakistanit dhe në Republikën e Gjeorgjisë, jorezident.

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**  
**Bujar Nishani**

**VENDIM**  
**Nr. 56, datë 21.12.2012**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 8.11.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 37 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Andrea Karanxha

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Tiranë  
Z. Spartak Çeta, përmbarues gjyqësor privat

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 167, datë 19.1.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Altina Xhoxhaj, shqyrtoi çështjen mbi aktet dhe diskutoi për të në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr. 524, datë 11.6.2007 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) Tiranë, kërkuesi, me detyrën inspektor kontrolli në Degën e Tatimeve Korçë, është liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur ankim në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), i cili, me vendimin nr. 261, datë 11.12.2007, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

2. Kërkuesi i është drejtuar me padi gjykatës së shkallës së parë. Me vendimin nr. 167, datë 19.1.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës. Anulimin e vendimit nr. 524, datë 11.6.2007 të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për lirimin nga shërbimi civil dhe kalimin në listën e pritjes të paditësit Andrea Karanxha dhe të vendimit nr. 261, datë 11.12.2007 të Komisionit të Shërbimit Civil, duke iu paguar paditësit Andrea Karanxha paga deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës.*” Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 133, datë 27.4.2009, të Gjykatës së Apelit Korçë.

3. Me vendimin nr. 431, datë 29.5.2009, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 167, datë 19.1.2009, të po asaj gjykate.

4. Me kërkesën e datës 3.6.2009, kërkuesi i është drejtuar DPT-së për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve ligjore dhe financiare që rrjedhin nga vendimi gjyqësor. Në datën 3.5.2010 kërkuesi i është drejtuar përsëri DPT-së me të njëjtën kërkesë. Me shkresën nr. 7382/1, datë 27.5.2010, DPT-ja i ka kthyer përgjigje kërkuesit se ka ushtruar rekurs ndaj vendimit të gjykatës së apelit dhe se vetëm pas marrjes së vendimit nga Gjykata e Lartë do të shqyrtojë kërkesën dhe do të ndjekë procedurat ligjore për ekzekutimin.

5. Me kërkesat e datës 5.1.2011 dhe 24.8.2011 kërkuesi i është drejtuar përsëri DPT-së për ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga vendimi gjyqësor i formës së prerë. Me shkresën nr. 16532/1, datë 24.9.2011, DPT-ja i ka kthyer përgjigje kërkuesit se ai nuk ka plotësuar dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës, më konkretisht se nuk ka paraqitur vendimin e Gjykatës së Lartë lidhur me këtë çështje.

6. Me vendimin nr. 00-2012-340, datë 10.2.2012, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga DPT-ja, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

7. Në datën 29.2.2012 kërkuesi i është drejtuar shërbimit përbarimor gjyqësor privat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të dhënë në favor të tij. Me shkresën e datës 29.2.2012, përbaruesi gjyqësor, z. Spartak Çeta, i është drejtuar debitorit DPT, me lajmërim për ekzekutimin vullnetar të detyrimit. Me shkresën e datës 11.5.2012, përbaruesi gjyqësor i ka dërguar Degës së Thesarit Tiranë urdhrin për vendosjen e sekuestros në llogarinë e palës debitore DPT.

8. **Kërkuesi Andrea Karanxha** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, me kërkesën e datës 18.6.2012, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Kërkuesi pretendon se pala debitore ka pasur të gjitha mundësitë për të ekzekutuar detyrimin që ka ndaj tij. Në lidhje me detyrimin financiar debitori kishte detyrimin ligjor që të planifikonte fondet që me lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, në vitin 2009, kurse për sa i përket rikthimit në punë, nga raportet e KSHC-së rezultojnë se që prej vitit 2008 DPT-ja ka rekrutuar rreth 200 punonjës, 95 prej tyre vetëm



në vitin 2011, pra kur kishte dijeni për vendimin gjyqësor të dhënë në favor të kërkuesit dhe kishte detyrimin ta zbatonte atë. Mosekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë e ka cenuar kërkuesin në personalitetin e tij, në të drejtën për punë, të drejtën e mbrojtjes shoqërore e shëndetësore në punë, si dhe ka përkeqësuar gjendjen e tij sociale dhe ekonomike.

9. **Subjekti i interesuar DPT**, në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës Kushtetuese, shprehet se rikthimi i kërkuesit në pozicionin e mëparshëm të punës ka qenë i pamundur, pasi në pozicionin që ka mbajtur, si inspektor i kontrollit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë, janë emëruar për nevoja pune punonjës të tjerë; pas emërimit këta punonjës kanë marrë statusin e nëpunësit civil dhe largimi i tyre është i paligjshëm dhe përbën shkelje për titullarin e institucionit. Lidhur me detyrimin për pagesën e pagës deri në momentin e rikthimit në punë, shkak për mosrealizimin e likuidimit në kohë dhe në vlerë të detyrimeve është bërë mungesa e fondeve. Fondi i alokuar nga buxheti i shtetit në vitet 2010-2011-2012 në shpenzimet operative, nuk i është përgjigjur nevojave të DPT-së, kurse kërkesat e këtij institucioni për shtesë për fonde për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nuk janë marrë parasys.

10. **Subjekti i interesuar përmbartuesi gjyqësor privat z. Spartak Çeta**, në komentin me shkrim drejtuar Gjykatës Kushtetuese, shprehet se pas plotësimit të dosjes ligjore i është drejtuar debitorit me lajmërim për ekzekutim vullnetar dhe, në mungesë të një përgjigjeje, ka vijuar me procedurën për ekzekutim të detyrueshëm dhe vendosjen e sekuestros në llogarinë e tij në degën e thesarit. Megjithatë, pavarësisht sa më sipër, pa asnjë shkak ligjor, debitori nuk ka pranuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.

## II

*A. Lidhur me pretendimin për mosekzekutimin, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë*

11. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, si një nga parimet themelore të një shoqërie demokratike, përmban në vetvete edhe detyrimin e autoriteteve publike për të vënë në ekzekutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Zbatimi i plotë dhe efektiv i vendimeve gjyqësore është me rëndësi thelbësore për shtetin, me qëllim që të krijojë, forcojë dhe zhvillojë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë (*shih vendimet nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 13, datë 22.4.2011; nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 49, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë përbën një element të rëndësishëm të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në vlerësimin e Gjykatës, gjykimi nuk duhet konceptuar ngushtë, vetëm me sigurimin e një vendimi gjyqësor, por me përfundimin e gjithë këtij procesi, sepse një e drejtë e fituar mbetet pa asnjë vlerë nëse nuk realizohet nëpërmjet ekzekutimit të vendimit. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij karshi kreditorit. Në raste të tilla mund të thuhet se procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave për rastin konkret, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 49, datë 21.11.2011; nr. 11, datë 2.3.2012; nr. 13, datë 21.3.2012; nr. 30, datë 16.5.2012; nr. 49, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces. Kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, duhet të vlerësohet

nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e kërkuarit, si dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 49, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

*i) Kompleksiteti i çështjes*

14. Në lidhje me kompleksitetin e çështjes, Gjykata ka theksuar, vazhdimisht, se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e saj, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore (*shih vendimet nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 10, datë 1.3.2012; nr. 49, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket rikthimit në punë dhe pagimit të pagës deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës. Duke iu referuar parashtimeve dhe materialeve shkresore, rezulton se çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të organeve të ngarkuara nga ligji me këtë qëllim.

*ii) Sjellja e kërkuarit*

16. Në lidhje me vlerësimin e sjelljes së kërkuarit Gjykata është shprehur se ai është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se një personi që pajiset me një vendim të ekzekutueshëm kundër shtetit në favorin e tij, nuk mund t'i kërkohej t'u drejtohet organeve përmbartimore për të ekzekutuar vendimin (*shih vendimin nr. 49, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në çështjen objekt shqyrtimi rezulton se kërkuari ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Pas dhënies së vendimit nga gjykata e apelit, ai i është drejtuar disa herë debitorit për ekzekutimin vullnetar të vendimit. Pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë, edhe pse urdhri i ekzekutimit është nxjerrë që pas përfundimit të gjykimit të çështjes në apel, kërkuari i është drejtuar shërbimit përmbartimor gjyqësor privat për të vënë në lëvizje procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm.

18. Përveç sa më sipër, kërkuari rezulton t'i jetë drejtuar edhe institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Pas disa komunikimeve që institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur me DPT-në, përfundimisht me shkresën nr. K2/A40-7 prot., datë 2.8.2012, i ka kthyer përgjigje kërkuarit, ku e informon lidhur me hapat e ndërmarrë nga ky institucion dhe i rekomandon t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

*iii) Sjellja e autoriteteve publike*

19. Në lidhje me sjelljen e debitorit DPT, rezulton se ky i fundit jo vetëm nuk ka bërë asnjë veprim që të krijojë bindjen se ka vullnetin për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, por madje ka refuzuar ekzekutimin e tij.

20. Fillimisht, bazuar në korrespondencën që ka pasur me kërkuarin, debitori ka përdorur si argument faktin se i është drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë dhe është në pritje të vendimit të asaj gjykate. Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të KPC-së, vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, në bazë të nenit 479 të KPC-së. Në rastin konkret, nuk rezulton që pala debitore të ketë ushtruar këtë mjet ligjor, dhe në kushtet kur ekzekutimi i vendimit gjyqësor nuk ishte pezulluar por, për më tepër, ishte lëshuar urdhri për ekzekutimin e tij, debitori kishte detyrimin të merrte të gjitha masat për ekzekutimin e detyrimeve që rrjedhin nga ai vendim. Edhe pas dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë dhe nisjen e procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm, rezulton se detyrimi që debitori DPT ka ndaj kërkuarit nuk është ekzekutuar ende.



21. Në bazë të ankesës së paraqitur nga kërkuesi, me shkresën nr. K2/A20-4 prot., datë 26.3.2012, Avokati i Popullit i është drejtuar drejtorit të përgjithshëm të DPT-së, në të cilën shprehet se qëndrimi i mbajtur prej këtij institucioni është në kundërshtim me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe rekomandon marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimeve të vendosura në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në përgjigje të kësaj shkrese, me shkresën nr. 6433/2 prot., datë 2.5.2012, DPT-ja shprehet se praktika e çështjes ndodhet në zyrën e financës, por aktualisht është në pamundësi financiare për të paguar dëmshpërblimet e ish-punonjësve të larguar nga administrata tatimore, kurse lidhur me atë pjesë të vendimit që disponon rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, shprehet se është në pamundësi ekzekutimi dhe se do të ekzekutohet sapo të krijohet mundësia.

22. Me shkresën nr. K2/Q11-3 prot., datë 27.7.2012, Avokati i Popullit i është drejtuar Ministrisë të Financave, me anë të së cilës rekomandon marrjen e nismës për fillimin e procedurës për dhënie mase disiplinore ndaj drejtorit të përgjithshëm të DPT-së, për shkak të qëndrimit të tij për mospërmbushje të detyrimeve të vendosura me vendime gjyqësore të formës së prerë.

23. Nga parashtrimet e subjektit të interesuar, përmbaruesi gjyqësor privat, rezulton se debitori nuk u është përgjigjur shkresave të tij dhe nuk e ka vënë atë në dijeni të asnjë mase të ndërmarrë me qëllim ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, kurse në parashtrimet drejtuar Gjykatës, DPT-ja shprehet se, lidhur me rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës është në pamundësi ekzekutimi, pasi në këtë pozicion janë emëruar punonjës të tjerë, kurse lidhur me atë pjesë të vendimit që disponon pagesën e pagës shprehet se është në pamundësi financiare.

24. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se i takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme me, qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimin nr. 2, datë 1.2.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata ka theksuar se kërkuesit nuk duhet t'i mohohet e drejta për të përfituar nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor thjesht duke u mbështetur në argumentin e pamundësisë financiare të shtetit. Në këtë drejtim, në rastet kur debitor është vetë shteti, autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. Një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 43, datë 19.12.2007; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 16, datë 4.5.2011; nr. 49, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Nisur nga arsyetimi i mësipërm, Gjykata vlerëson se argumentet e paraqitura nga DPT-ja, lidhur me arsyet se përse nuk është ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë, janë të pambështetura.

25. Lidhur me sjelljen e organit të caktuar nga ligji për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Gjykata ka nënvizuar, vazhdimisht, se në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 4.3.2010*).

26. Në vlerësimin e Gjykatës, përmbaruesi gjyqësor, si subjekt procedural në fushën e ekzekutimit, është i pajisur me të gjitha mjetet procedurale që mundësojnë ekzekutimin e titullit ekzekutiv (*shih vendimet nr. 21, datë 3.6.2011; nr. 10, datë 1.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuesi i është drejtuar shërbimit përmbarimor gjyqësor privat për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit gjyqësor të dhënë në favor të tij. Me shkresën e datës 29.2.2012, përmbaruesi gjyqësor i është drejtuar debitorit DPT, me lajmërim për ekzekutimin vullnetar. Me shkresën e datës 11.5.2012, përmbaruesi gjyqësor i ka dërguar Degës së Thesarit Tiranë urdhrin për vendosjen e sekuestros në llogarinë e palës debitore. Pavarësisht mjeteve

të përdorura nga përmbaruesi gjyqësor, nuk rezulton që vendimi gjyqësor i formës së prerë të jetë ekzekutuar ende. Në vlerësimin e Gjykatës këto mjete kanë qenë formale dhe ky subjekt nuk ka përdorur të gjitha mjetet ligjore shtrënguese në dispozicion, siç është aplikimi i sanksioneve ndaj personave përgjegjës për mosekzekutimin.

Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se organet shtetërore, nëpërmjet sjelljes së tyre, kanë cenuar të drejtën e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të mosekzekutimit të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës, duke konstatuar cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 167, datë 19.1.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj, Fatmir Hoxha

#### VENDIM

**Nr. 57, datë 21.12.2012**

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 27.9.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 24 Akti, që i përket:

KËRKUES: Nehat Kulla, përfaqësuar nga avokatët Baftjar Rusi dhe Qazim Gjonaj, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.



OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtuëshëm me Kushtetutën, i vendimeve: nr. 109, datë 14.8.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë; nr. 85, datë 17.3.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2010-766-540, datë 26.5.2010 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë;

Dërgimi i çështjes për rishqyrtim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g, të Kushtetutës; nenet 5.1 dhe 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); neni 4 i protokollit nr. 7 të KEDNJ-së; nenet 27, 28, 29, 30, 39, 42 e vijues të ligjit 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha, përfaqësuesit e kërkuarit që kërkuan pranimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 109, datë 14.8.2008, ka vendosur deklarimin fajtor të kërkuarit për kryerjen e veprave penale të: “Vrasjes me dashje”, të parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal (KP) dhe dënimin e tij me 18 vjet burgim; të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuar nga neni 278/2 i KP-së dhe dënimin me 3 vjet burgim. Në bashkim të dënimeve, në zbatim të nenit 55/1 të KP-së, i pandehuri është dënuar përfundimisht me 20 vjet burgim.

2. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 85, datë 17.3.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

3. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 540, datë 26.5.2010, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

#### II

4. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 16.11.2011, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

4.1 Hetimet paraprake janë kryer në shkelje të garancive kushtetuese dhe të Kodit të Procedurës Penale (KPP), për arsyet si vijon:

4.1.1 Nuk janë respektuar afatet procedurale për fillimin dhe zgjatjen e hetimeve paraprake, sipas parashikimeve të neneve 323 e 324 të KPP-së. Për rrjedhojë, kërkuesi ka humbur të drejtën e ankimit në kuptim të nenit 325 të KPP-së dhe nenit 43 të Kushtetutës.

4.1.2 “Procesverbali i njohjes së personit”, i datës 15.11.2005, është kryer në mungesë të mbrojtësit, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes. Në kuptim të neneve 128/1 dhe 131/1 të KPP-së, ky akt, dhe aktet e tjera që varen prej tij, janë absolutisht të pavlefshëm.

4.1.3 Vendimet “Për caktimin e përkthyesit”, të datave 1.10.2007 dhe 2.10.2007, janë marrë në shkelje të neneve 123, 125, 126, 138, 179/2, 183 të KPP-së, pasi nuk gjendet e depozituar në fashikullin hetimor asnjë deklaratë me shkrim e shtetasit të huaj që nuk njeh gjuhën shqipe; asnjë dokument që të vërtetojë identitetin e personave të caktuar si përkthyes dhe faktin që ata e gëzojnë të drejtën ligjore për të ushtruar një detyrë të tillë. Për rrjedhojë, kërkuarit i është privuar e drejta e njoftimit dhe e drejta e paraqitjes së kërkesës për përjashtimin e përkthyesit.

4.1.4 Procesverbali i “Marrjes në pyetje të shtetasit të huaj me cilësinë e personit që ka dijëni për veprën penale”, i datës 1.10.2007, është hartuar në shkelje të nenit 122 të KPP-së, pasi është hartuar në mungesë të përkthyesit të caktuar nga organi procedues dhe duke marrë si përkthyes bashkëshorten e tij.

4.1.5 Vendimi “Për lejimin e përgjimit ambiental” të shtetasit italian M.C. dhe bashkëshortes së tij E.SH., i datës 1.10.2007, është marrë në shkelje të neneve 222, 223, 116 të KPP-së. Rezultatet e përgjimit nuk u janë njoftuar të pandehurit dhe mbrojtësit, çka në kuptim të nenit 223/4 të KPP-së përbën cenim të së drejtës së mbrojtjes.

4.1.6 Kërkuesi nuk është njohur me aktet e fashikullit hetimor të datës 13.11.2007, pasi ka qenë në dhomat e paraburgimit të Burgut 302. Aktet i janë vënë në dispozicion vetëm mbrojtësit të tij, në shkelje të nenit 327/2 në lidhje me nenin 50 të KPP-së dhe neneve 31/c dhe 33/1 të Kushtetutës.

4.1.7 “Vendimi për dërgimin e çështjes në gjyq”, i datës 14.11.2007, nuk gjendet në dosjen penale nr. 182/2005 dhe nuk i është njoftuar as të pandehurit dhe as mbrojtësit të tij, çka ka cenuar të drejtën e mbrojtjes për shkak të mosnjoftimit dhe afatit shumë të shkurtër kohor (vetëm 24 orë) nga mbyllja e hetimeve paraprake dhe dërgimi i çështjes në gjyq, në kuptim të nenit 31/b të Kushtetutës.

5. Është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe i sigurisë juridike* nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata e Apelit Durrës, të cilat nuk kanë pranuar provat e mbrojtjes, por kanë pranuar t’i nënshtrojnë hetimit gjyqësor vetëm provat e akuzës. Gjykata e Apelit, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, të marrë në shkelje të parimeve kushtetuese e procedurale penale, bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, pasi ka cenuar besimin e kërkuesit të sistemi i drejtësisë dhe rendi kushtetues.

6. Është cenuar *parimi i prezumimit të pafajësisë*, parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë vlerësuar dyshimet në favor të të pandehurit, por e kanë vlerësuar si të mirëqenë akuzën.

7. Është cenuar *parimi i gjykimit të çështjes nga një gjykatë e paanshme*, pasi trupi gjyqësor ka pranuar çdo provë të kërkuar prej akuzës dhe ka refuzuar çdo kërkesë të mbrojtjes. Njëanshmëria e gjykatave u vërtetua edhe nga rrëzimi i kërkesave për përjashtimin e trupit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe të një anëtarit të trupit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Durrës. Për më tepër, vendimi për mospërjashtimin e gjyqtarëve nuk iu komunikua kërkuesit, duke i mohuar kështu të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë.

8. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata e Apelit Durrës nuk kanë respektuar *standardin kushtetues të arsytimit të vendimeve gjyqësore*, pasi nuk parashtrajnë arsyet për të cilat këto gjykata i quajnë të papranueshme provat e kundërta. Për më tepër, Gjykata e Apelit, edhe pse ka pranuar marrjen kryesisht të provave, nuk i bën ato pjesë të arsytimit të vendimit.

9. Është cenuar *e drejta e mbrojtjes në Gjykatën e Lartë*, pasi procesi gjyqësor është zhvilluar në mungesë të mbrojtësve të zgjedhur nga kërkuesi, të cilët kishin paraqitur kërkesë për shtyrjen e seancës, dhe pa i caktuar mbrojtës kryesisht.

10. ***Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme***, në prapësimet dërguar me shkrim Gjykatës, shprehet se:

10.1 Kërkuesi nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese e ligjore gjatë fazës së hetimeve paraprake, konkretisht lidhur me pretendimet për hartimin e procesverbalit të njohjes në mungesë të mbrojtësit, për nënshkrimin e vendimeve të zgjatjes së hetimeve paraprake nga mbrojtësi i paautorizuar, për mosnënshkrimin e vendimit “Për dërgimin e çështjes në gjyq” nga kërkuesi. Këto pretendime, së bashku me pretendimin për mosarsyetimin e vendimeve gjyqësore, nuk janë parashtruar nga kërkuesi në asnjë fazë të procedimit të çështjes.

10.2 Pretendimet e kërkuesit për cenimin e barazisë së armëve si rezultat i mosmarrjes së provave të kërkuara prej tij ose prej mbrojtësve të tij, i vlerësimi jo të drejtë të tyre, si dhe interpretimit e zbatimit të gabuar të ligjit, janë çështje që i përkasin juridiksionit të gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë dhënë përgjigje këtyre pretendimeve përmes vendimeve gjyqësore. Në





këtë kuptim, pretendimet nuk përbëjnë cenim të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues.

10.3 Edhe pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit të çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykatën e Apelit Durrës, është i pabazuar në rrethanat e faktet e provuara dhe në interpretim të kërkesave kushtetuese, konventore e ligjore, konkretisht neneve 15, 16 e 17 të KPP-së, nenit 42/2 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Për më tepër, këto pretendime janë shqyrtuar dhe kanë marrë përgjigje në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe të Gjykatës së Apelit Durrës, në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës.

10.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë si rezultat i zhvillimit të seancës gjyqësore në mungesë të mbrojtësve. Rekursi është paraqitur nga mbrojtësit me prokurë të kërkuarit, të cilët kanë parashtruar të gjitha argumentet ligjore në rekurs dhe shtesë rekursi. Po ashtu, nuk rezulton që Kolegji Penal të ketë dhënë vendim për rëndimin e pozitës së kërkuarit, pasi nuk ka ndryshuar në disfavor të kërkuarit vendimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

### III

*A. Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës për mosdeklarimin fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*

11. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) konstaton paraprakisht se kërkuari, në thelb, ka pretenduar mosrespektimin e rregullave për llogaritjen e afateve të fillimit dhe përfundimit të hetimeve paraprake, si dhe cenimin e garancive kushtetuese dhe procedurale penale gjatë këtyre hetimeve. Konkretisht, kërkuari pretendon se afati i hetimeve paraprake duhej llogaritur nga data 29.7.1998 kur është marrë “Vendimi për kryerjen e ekspertimit daktilografik”, sipas të cilit rezulton se personi i dyshuar si i tillë ishte kërkuari. Po ashtu, hetimet paraprake e kanë tejkaluar afatin ligjor për shkak të ndërprerjeve në periudhat kohore nga 29.7.1998 deri më 6.1.1999 nga Prokuroria e Rrethit Kavajë, nga 20.12.1999 deri më 31.3.2000 nga Prokuroria e Rrethit Elbasan dhe nga 14.11.2005 deri më 14.11.2007 nga Prokuroria e Rrethit Kavajë. Njoftimi për zgjatjen e afateve të hetimeve paraprake i është bërë mbrojtësit dhe jo të pandehurit. Gjithashtu, kërkuari pretendon parregullsi edhe gjatë kryerjes së veprimeve hetimore si paraqitja për njohje, përgjimi ambiental, caktimi i përkthyesit, marrja në pyetje e shtetasit të huaj me cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Për rrjedhojë, kërkuari pretendon se aktet procedurale që pasqyrojnë këto veprime hetimore janë absolutisht të pavlefshme.

12. Gjykata ka theksuar se, bazuar në parimin *jura novit curia*, ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar, që nuk është parashtruar para saj dhe ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që i është bërë fakteve të çështjes nga kërkuari (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit duhet të trajtohen në këndvështrim të respektimit të parimit të mosdeklarimit fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, në kuptim të nenit 32/2 të Kushtetutës.

13. Sipas jurisprudencës kushtetuese, marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbën një aspekt të rëndësishëm të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Në këtë drejtim, detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë. Parimi bazë kushtetues që lidh provat me procesin e rregullt është i sanksionuar në nenin 32/2 të Kushtetutës, sipas të cilit askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Për të përcaktuar nëse procesi ka qenë i rregullt, duhet kontrolluar nëse e drejta e mbrojtjes është respektuar dhe duhet verifikuar në veçanti nëse kërkuarit i është dhënë mundësia për të vënë në dyshim autenticitetin e provave dhe kundërshtuar përdorimin e tyre (*shih vendimin nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Po ashtu, në qëndrimet e arsyetimet e veta Gjykata, ndërsa ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues, ka pranuar gjithashtu, se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Duke shkuar më tej, Gjykata nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 21, datë 1.10.2008; nr. 40, datë 22.9.2011, nr. 18, datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata konstaton se në dosjen hetimore (fq. 41) gjendet e administruar shkresa “Informacion mbi procedimin penal nr. 182/2005”, datë 13.9.2007, dërguar Prokurorisë së Përgjithshme, nga përmbajtja e së cilës rezulton se Prokuroria e Rrethit Kavajë, në datën 5.8.1998, ka filluar hetimet për procedimin penal nr. 93 për veprën penale të vrasjes me dashje, pa autor, por në datë 6.1.1999 është vendosur pezullimi i hetimeve për shkak të moszbulimit të autorit të veprës penale. Hetimet kanë rifilluar në datën 14.11.2005 ku vepra penale i është atribuar personit nën hetim (kërkuesit), i cili është arrestuar në flagrancë më datë 15.11.2005 dhe i është caktuar masa e sigurimit personal në burg. Për shkak të kompleksitetit të hetimit që lidhet me dëshmitarët që ndodheshin jashtë shtetit, adresa e të cilëve nuk dihej, afatet hetimore janë zgjatur dhe afati 2-vjeçar i hetimit ka përfunduar në datën 14.6.2007, por nisur nga nevoja për kryerjen e veprimeve të tjera hetimore (dërgimi i letërporosisë në shtetin italian, identifikimi i lidhjeve shoqërore të të pandehurit dhe krahasimin e gjurmëve të tyre me ato të gjetura në makinë, por ende të paidentifikuara), mbi bazën e kërkesës së prokurores së çështjes për zgjatjen e hetimeve, Prokurori i Përgjithshëm e ka miratuar zgjatjen e hetimeve, në përputhje me nenin 324 të KPP-së. Vendimet për zgjatjen e hetimeve paraprake, në periudhën 14.2.2006-14.5.2006-14.8.2006-14.11.2006, janë nënshkruar nga i pandehuri dhe mbrojtësi. Vendimet e zgjatjes së afateve të hetimit, në periudhën 14.2.2007-14.5.2007-14.6.2007-14.9.2007-14.12.2007, janë nënshkruar vetëm nga mbrojtësi i zgjedhur nga kërkuesi dhe i pajisur me tagra përfaqësimi, në përputhje me dispozitat e KPP-së.

16. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mosrespektimin e afateve procedurale të fillimit të hetimeve paraprake, zgjatjen e tyre tej afateve të parashikuara nga ligji, për mospërdorimin e veprimeve hetimore të kryera tej afateve dhe, për rrjedhojë, cenimin e të drejtës së mbrojtjes dhe ankimit, është i pabazuar. Për më tepër, këto pretendime kanë marrë përgjigje me vendimet gjyqësore.

17. Po ashtu, Gjykata konstaton se pretendimet e kërkuesit në lidhje me pavlefshmërinë e disa akteve procedurale janë parashtruar paraprakisht nga mbrojtësit e kërkuesit në seancën gjyqësore të datës 11.2.2008, të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Konkretisht, mbrojtësit kanë kërkuar deklarimin si të pavlefshme të vendimeve “Për caktimin e përkthyesit”, të datave 01.10.2007 dhe 02.10.2007, pasi janë marrë në shkelje të neneve 123, 125, 126, 138, 179/2, 183 të KPP-së. Sipas tyre, në fashikullin hetimor nuk gjendet e depozituar asnjë deklaratë me shkrim e shtetasit të huaj që nuk njih gjuhën shqipe dhe asnjë dokument që të vërtetojë identitetin e personave të caktuar si përkthyes dhe faktin që ata e gëzojnë të drejtën ligjore për të ushtruar një detyrë të tillë. Në këto kushte, kërkuesit i është privuar e drejta e njoftimit dhe, për rrjedhojë, e drejta e paraqitjes së kërkesës për përjashtimin e përkthyesit. Gjithashtu, mbrojtësit kanë kërkuar edhe pavlefshmërinë e vendimeve të prokurores së çështjes, për kryerjen e përgjimit ambiantal, dhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për vleftësimin e përgjimit, pasi janë marrë në shkelje të kërkesave të Seksionit IV, “Përgjimet” të KPP-së. Sipas mbrojtësve të kërkuesit, normat procedurale, në asnjë rast, nuk parashikojnë përgjimin e dëshmitarit apo të shtetasit të lirë. Për më tepër, të drejtën e përpilimit të këtij akti e ka vetëm prokurori i çështjes dhe jo oficeri i policisë gjyqësore. Po ashtu, përgjimi është kryer në mungesë të përkthyesit, të ekspertit kriminalistik dhe në kundërshtim me konkluzionet e procesverbalit “Për njohje personi” të së njëjtës datë.



18. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, Gjykata vëren se, bazuar në materialet e dosjes gjyqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë është shprehur me vendim të ndërmjetëm për rrëzimin e këtyre kërkesave, me arsyetimin se veprimet hetimore të pretenduara si të pavlefshme janë kryer në përputhje me normat përkatëse procedurale penale. Po ashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë vijon arsyetimin se: *“mbrojtësi dhe i pandehuri kanë marrë dijeni për veprimet hetimore dhe përfundimin e hetimeve, sipas procesverbalit të datës 13.11.2007, pa u shprehur për këto pretendime”*.

19. Gjithashtu, Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit Durrës, në seancën e datës 29.1.2009, ka pranuar kërkesën e mbrojtësve të kërkuesit për të përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor dhe, konkretisht, ka lejuar, midis të tjerash, pyetjen e përkthyesve lidhur me transkriptimin dhe përkthimin e përgjimit ambiantal të shtetasve M.S. dhe E.SH. dhe shqyrtimin si provë të kasetës së përgjimit ambiantal për ta dëgjuar në prani të palëve dhe përkthyesve.

20. Në vështrim të rrethanave të çështjes dhe standardeve të mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata e Apelit Durrës, në lidhje me pretendimet e parashtruara. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për deklarimin fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, është haptazi i pabazuar.

*B. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të sigurisë juridike*

21. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykata e Apelit Durrës nuk kanë pranuar provat e mbrojtjes, por kanë pranuar t'i nënshtrojnë hetimit gjyqësor vetëm provat e akuzës. Për më tepër, Gjykata e Apelit, duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë të marrë në shkelje të parimeve kushtetuese e procedurale penale, nuk ka respektuar parimin e sigurisë juridike, gjë që ka cenuar besimin e kërkuesit te sistemi i drejtësisë dhe rendi kushtetues.

22. Gjykata, paraprakisht, vlerëson se pretendimet e parashtruara nga kërkuesi duhet të trajtohen nga këndvështrimi i respektimit të parimit të barazisë së armëve.

23. Gjykata ka theksuar se veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe, lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, përbëjnë në vetvete elementet më të qenësishëm e thelbësorë të procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Prandaj, për respektimin e këtyre parimeve, gjykata duhet të përmbushë me rigorozitet një sërë detyrimesh, mes të cilave rëndësi të veçantë paraqet, sipas rastit, edhe njoftimi i të pandehurit apo mbrojtësit të tij ligjor për akuzën, ankimin, rekursin, ditën dhe vendin e gjykimit të çështjes, etj. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga gjykata, me objektivitet e paanësi. Këto kërkesa kushtetuese e ligjore janë në funksion të mbrojtjes sa më efektive të të pandehurit, pasi përballë tij qëndron vetë shteti, i përfaqësuar në procesin penal nga prokurori që paraqet dhe mbron akuzën kundër tij (*shih vendimet nr. 23, datë 13.10.2005; nr. 24, datë 26.10.2005; nr. 16, datë 8.6.2006; nr. 13, datë 21.7.2008; nr. 19, datë 18.9.2008; nr. 10, datë 2.4.2009; nr. 16, datë 15.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Gjykata konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në seancën e datës 29.2.2008 (fq. 306-312 e fashikullit), pasi ka dëgjuar palët e pranishme, ka vlerësuar si të bazuara kërkesat e prokurorit të çështjes për thirrje dëshmitarësh. Lidhur me kërkesat e paraqitura nga mbrojtësit e kërkuesit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendim të ndërmjetëm të arsyetuar, ka vendosur rrëzimin e kërkesave të paraqitura nga mbrojtësi i kërkuesit për: i) thirrje të disa dëshmitarëve, pasi dëshmia e tyre ishte indirekte, ndërkohë që gjykata do të thërriste shtetasin italian M.C. që ishte burimi i provës; ii) për paraqitjen e përkthyesit, pasi në vlerësimin e gjykatës, pretendimi i mbrojtjes për shtrembërim të përkthimit ishte i pabazuar. Kjo provë do t'i nënshtrohet debatit gjyqësor; në 10506

këtë mënyrë mbrojtja ka hapësira për të paraqitur pretendimet e veta; iii) për administrim të fashikullit të masës së sigurimit ndaj shtetasit italian M.C., pasi gjykata nuk vë në dispozicion prova, por palët kanë të drejtën e informimit dhe mund ta sigurojnë vetë materialin; iv) për administrim dhe shqyrtim të përkthimeve të bëra privatisht dhe jo në përputhje me kërkesat procedurale. Mbrojtësi e ka konsideruar vendimin e gjykatës si shprehje të njëanshmërisë së trupit gjykues, duke kërkuar përjashtimin e tij.

25. Gjkata vlerëson se asnjë nga palët në proces nuk është vënë në disavantazh, por secila ka pasur mundësinë të kërkojë administrimin e provave që i vlerëson të nevojshme. Kërkuesi ka qenë i përfaqësuar gjatë këtyre proceseve gjyqësore nga mbrojtës të zgjedhur personalisht, të cilët kanë pasur mundësinë e arsyeshme të informohen plotësisht për akuzat e ngritura, për të komentuar dhe kundërshtuar, përmes debatit kontradiktor, provat e paraqitura nga akuza, për të parashtruar kërkesa për marrjen e provave që i kanë vlerësuar si kyçe për të mbështetur pretendimet e tyre, si dhe për të përgatitur një mbrojtje efektive për mbrojtjen e interesave ligjore të kërkuesit.

26. Në vështrim të sa më sipër, si dhe duke ritheksuar qëndrimin tashmë të konsoliduar të jurisprudencës kushtetuese se çështjet e interpretimit të ligjit dhe vlerësimit të provave i takojnë sferës së juridiksionit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues, Gjykata arrin në përfundimin se edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor në ngarkim të tij, është i pabazuar.

*C. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e paanshme*

27. Kërkuesi, bazuar mbi argumentin se trupi gjykues u bë palë me akuzën, duke pranuar çdo provë të kërkuar prej saj dhe duke refuzuar çdo kërkesë të mbrojtjes, ka pretenduar gjithashtu, cenimin e standardit të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e paanshme. Sipas tij, refuzimi i kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe të një anëtari të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës, vërtetoi njëanshmërinë e gjykatës. Për më tepër, vendimi për mospërjashtimin e gjyqtarëve nuk iu komunikua kërkuesit, duke i mohuar atij të drejtën e rekursit në Gjykatën e Lartë.

28. Gjkata, në jurisprudencën kushtetuese, është shprehur se një nga elementet e rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, është gjykimi i çështjes nga një gjykatë e paanshme. Gjkata merr parasysh, *inter alia*, veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk ofrojnë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimin nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën kur gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës, kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike, duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjkata konstaton se mbrojtësi i kërkuesit ka qenë i pranishëm në seancën gjyqësore kur dhe është marrë vendimi nr. 35, datë 18.3.2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë që ka vendosur mospranimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit, fakt i cili prezumon edhe marrjen dijeni për shpalljen e vendimit dhe përmbajtjen e tij. Për më tepër, rezulton se i pandehuri ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 219, datë 19.5.2008, ka vendosur mospranimin e rekursit.



30. Pavarësisht rrethanave të mësipërme, Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuesit nuk është ngritur në nivel kushtetues, për faktin se mungojnë argumentet për të provuar se gjykatat nuk kanë ofruar garanci procedurale të mjaftueshme dhe se kanë pasur interesa personale në çështjen në shqyrtim (testi objektiv dhe subjektiv). Madje, argumentet e parashtruara në mbështetje të pretendimit mbi vlerësimin e njëanshëm të provave janë çështje që i takojnë sferës së kompetencës të gjykatave të zakonshme për interpretimin e dispozitave ligjore dhe vlerësimin juridik të rrethanave dhe provave të parashtruara nga palët dhe jo juridiksionit kushtetues. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor.

31. Në këtë vështrim, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

*Ç. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë*

32. Sipas pretendimeve të kërkuesit, Gjykatat nuk kanë respektuar parimin *in dubio pro reo*, pasi dyshimet nuk i kanë vlerësuar në favor të të pandehurit.

33. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërës të procesit të rregullt ligjor. Sipas nenit 30 të Kushtetutës, kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilëve është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuzat. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individi të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal, mjafton që të ketë një arsytim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor (*shih vendimin nr. 47, datë 7.11.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Nga vlerësimi në tërësi i materialeve të dosjes gjyqësore, Gjykata vëren se nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se anëtarët e gjykatave të zakonshme, që kanë shqyrtuar çështjen në ngarkim të kërkuesit, e kanë filluar procesin me paragjykimin se ai ka qenë autori i kryerjes së veprës penale për të cilën akuzohet.

35. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se edhe pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

*D. Në lidhje me pretendimin për cenimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor*

36. Sipas kërkuesit, gjykatat e zakonshme nuk parashtrajnë arsytet për të cilat ato i quajnë të papranueshme provat e kundërta dhe përmbajnë vlerësime alogjike të provave të administruara. Për më tepër, Gjykata e Apelit, edhe pse ka pranuar marrjen kryesisht të provave, nuk i bën ato pjesë të arsytimit të vendimit.

37. Gjykata është shprehur se elementet që duhet të përmbajë një vendim penal përcaktohen shprehimisht nga KPP-ja, që parashikon, gjithashtu, se nëse vendimi nuk arsyetohet, ai është i pavlefshëm. Konkretisht, neni 383 i KPP-së përcakton, ndër të tjera, detyrimin e gjykatës për të pasqyruar në vendim parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, arsytet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit. Vendimi gjyqësor duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën

bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimet nr. 12, datë 2.4.2008 dhe nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në çdo rast, vendimi gjyqësor duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Përfundimet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimin nr. 8, datë 16.3.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se Gjykata e Apelit, në seancën e datës 29.1.2009, ka vendosur përsëritjen e pjesës së shqyrtimit gjyqësor, duke lejuar marrjen e disa provave (procesverbalin e seancës gjyqësore të fashikullit të gjykimit që i përket caktimit të masës së sigurimit të shtetasit italian M.C.; pyetjen e dy përkthyesve lidhur me transkriptimin dhe përkthimin e përgjimit ambiental). Gjykata e Apelit, kryesisht, ka vendosur të shqyrtojë si provë kasetën e përgjimit ambiental për ta dëgjuar në prani të palëve dhe të përkthyesve.

40. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata e Apelit në vendim (fq.7-8) arsyeton se ka përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor duke pranuar kërkesën e mbrojtjes për marrjen provave të mësipërme, të cilat nuk i janë lejuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Prova e marrë kryesisht (kaseta e përgjimit) është analizuar në pjesën arsyetuese të vendimit të Gjykatës Apelit Durrës, e cila përshkruan në mënyrë të detajuar procesin e dëgjimit të kasetës së përgjimit ambiental, duke arritur në përfundimin se, i analizuar në harmoni me veprimin hetimor të paraqitjes për njohje të shtetasit italian M.C. dhe me rezultatet e përgjimit ambiental, Gjykatës i krijohet bindja se i pandehuri është autori i veprës penale.

41. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se, në ndryshim me sa pretendon kërkuesi, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arritur të shpjegojnë mjaftueshmërisht arsyet e themelit të dhënies së këtij vendimi, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, provave të administruara të cilat janë analizuar në harmoni me njëra-tjetrën, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve në gjykim, ç'ka ka përmbushur përgjithësisht detyrimin e sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës.

42. Si përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është i pabazuar.

*DH. Në lidhje me pretendimin për cenimin e të drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë*

43. Kërkuesi pretendon se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë i ka cenuar të drejtën e mbrojtjes, pasi është zhvilluar në mungesë të mbrojtësve të zgjedhur prej tij dhe pa i caktuar mbrojtës kryesisht.

44. Në jurisprudencën e saj, Gjykata e ka pranuar ekzistencën e mbrojtjes si tregues thelbësor të një procesi të rregullt penal. Që e drejta e mbrojtjes të jetë reale dhe efektive dhe jo vetëm teorike, ushtrimi i saj nuk duhet të pengohet, por përkundrazi, gjykata duhet të marrë të gjitha masat ligjore që në funksion të procesit të drejtë, jo vetëm të sigurojë praninë e mbrojtësit në gjykim, por dhe t'i japë atij mundësinë të bëjë mbrojtje reale, duke respektuar barazinë e armëve. E drejta e gjithkujt, të akuzuar penalisht, për të qenë efektivisht i mbrojtur nga një avokat, kur është e nevojshme edhe i caktuar kryesisht, është një nga tiparet themelore të një gjykimi të drejtë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).



45. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, është vlerësuar se situata juridike kur rekursi paraqitet nga i akuzuari, nuk është e njëjlojtë me rastin kur rekursi paraqitet nga prokurori. Prania personale e të pandehurit në seancën gjyqësore, për shqyrtimin e ankimit të paraqitur nga mbrojtësi i tij, nuk është e domosdoshme, nëse objekt shqyrtimi janë trajtimet dhe përfundimet juridike të arritura nga gjykata më e ulët, vendimi i së cilës nuk mund të ndryshohet në disfavor të të pandehurit. Në këto raste, Gjykata e Lartë nuk ka ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të avokatit të palës së akuzuar kur ai mungon pa shkaqe të arsyeshme, për arsye se argumentet ligjore mbrojtësi i ka depozituar me shkrim në rekursin e paraqitur përpara saj. Ndryshe paraqitet situata kur, si rrjedhojë e një rekursi të paraqitur nga prokurori, që mbart në potencë mundësinë e përkeqësimit të pozitës së të pandehurit, gjykimi të zhvillohej pa praninë e të gjykuarit ose të avokatit të tij. Në këtë rast, nëse as avokati dhe as i pandehuri nuk paraqiten në seancë në Gjykatën e Lartë, është e palejueshme që ajo të vazhdojë. Prezumimi se i pandehuri nuk ka marrë pjesë në gjykim me vetëdije, mund të justifikohet vetëm nëse atij i është bërë njoftimi personalisht dhe mund të vërtetohet që ai e ka marrë vetë atë. Në aspektin e garantimit të procesit të rregullt ligjor, për Gjykatën e Lartë del e domosdoshme marrja e masave në mënyrë që të mos lejojë zhvillimin e seancës në mungesë të përfaqësuesit të interesave të të pandehurit, pasi kjo është e vetmja mënyrë që i pandehuri, përmes figurës përfaqësuese të avokatit, të marrë pjesë në debatet e mundshme (shih vendimet nr. 23, datë 13.10.2005; nr. 24, datë 26.10.2005; nr. 5, datë 4.2.2008; nr. 13, datë 21.7.2008; nr. 16, datë 15.6.2009; nr. 28, datë 2.10.2009; nr. 30, datë 26.11.2009; nr. 37, datë 24.12.2010; nr. 40, datë 22.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

46. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës është depozituar rekurs nga mbrojtësit e të pandehurit dhe shtesë rekursi, e nënshkruar nga vetë i pandehuri. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur kalimin e rekursit për shqyrtim në seancë gjyqësore. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 14.4.2010, rezulton se seanca nuk është zhvilluar dhe shkak për shtyrjen ka qenë depozitimi, nga ana e mbrojtësve të të pandehurit, i dy kërkesave për shtyrjen e seancës, të cilat janë pranuar nga Kolegji Penal. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 26.5.2010, rezulton se përsëri mbrojtësit e të pandehurit kanë depozituar dy kërkesa për shtyrjen e procesit, të cilat nuk janë pranuar nga Kolegji Penal, i cili ka vendosur vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor në mungesë të mbrojtësve, me arsyetimin se “*kërkesat e përsëritura të avokatëve të të gjykuarit zvarrisin gjykimin e çështjes*”. Edhe në vendimin nr. 540, datë 26.5.2010, Kolegji Penal arsyeton se “*...ka vendosur të vazhdojë gjykimin pa praninë e mbrojtësve, duke çmuar se u është dhënë mundësia duke shtyrë seancën e mëparshme për të qenë të pranishëm dhe për të parashtruar mbrojtjen e të gjykuarit. Kur rezulton se rekursi është paraqitur nga vetë mbrojtësit e të gjykuarit, Kolegji ka konkluduar se kërkesat e njëpasnjëshme për shtyrje të seancave nga ana e mbrojtësve, të cilët, në bazë të aktit të përfaqësimit, mund ta mbronin së bashku ose veç e veç të gjykuarin, janë bërë me qëllim zvarritjen e gjykimit.*” (fq. 4)

47. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të paraqitur nga kërkuesi dhe, në përfundim të gjykimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës. Vendimi i Kolegjit Penal nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit, pasi nuk ka ndryshuar në disfavor të tij vendimet e gjykatave më të ulëta. Në këto kushte, duke qenë se të gjitha argumentet ligjore kanë qenë të depozituara me shkrim në rekurs dhe shtesën e rekursit, Gjykata e Lartë nuk kishte ndonjë pengesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes edhe në mungesë të mbrojtësve të kërkuesit, të cilët, pa shkak të arsyeshem, nuk kanë marrë pjesë.

48. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuesit për cenimin e të drejtës së mbrojtjes në Gjykatën e Lartë, është haptazi i pabazuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash:

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.  
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha

#### MENDIM PAKICE

Jemi kundër mendimit të shumicës në lidhje me vlerësimin si të pabazuar të pretendimit të kërkuarit për cenimin e parimit të barazisë së armëve, gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe në Gjykatën e Apelit Durrës.

1. Nga rrethanat e çështjes, rezulton se kërkuari ka pretenduar se gjykatat, gjatë shqyrtimit të akuzës kundër tij, nuk kanë pranuar provat e mbrojtjes, konkretisht, kërkesat e paraqitura nga mbrojtësi i kërkuarit: i) për thirrje të disa dëshmitarëve, pasi dëshmia e tyre ishte indirekte, ndërkohë që gjykata do të thërriste shtetasin italian M.C. që ishte burimi i provës; ii) për paraqitjen e përkthyesit, pasi në vlerësimin e gjykatës, pretendimi i mbrojtjes për shtrembërim të përkthimit ishte i pabazuar. Kjo provë do t’i nënshtrohet debatit gjyqësor; në këtë mënyrë mbrojtja ka hapësira për të paraqitur pretendimet e veta; iii) për administrim të fashikullit të masës së sigurimit ndaj shtetasit italian M.C., pasi gjykata nuk vë në dispozicion prova, por palët kanë të drejtën e informimit dhe mund ta sigurojnë vetë materialin; iv) për administrim dhe shqyrtim të përkthimeve të bëra privatisht dhe jo në përputhje me kërkesat procedurale.

2. Shumica arsyeton se asnjë nga palët në proces nuk është vënë në disavantazh, por secila ka pasur mundësinë të kërkojë administrimin e provave që i vlerëson të nevojshme. Kërkuari ka qenë i përfaqësuar gjatë këtyre proceseve gjyqësore nga mbrojtës të zgjedhur personalisht, të cilët kanë pasur mundësinë e arsyeshme të informohen plotësisht për akuzat e ngritura, për të komentuar dhe kundërshtuar, përmes debatit kontradiktor, provat e paraqitura nga akuza, për të parashtuar kërkesa për marrjen e provave që i kanë vlerësuar si kyçe për të mbështetur pretendimet e tyre, si dhe për të përgatitur një mbrojtje efektive për mbrojtjen e interesave ligjore të kërkuarit (shih prg. 25).

3. Konkluzioni i mësipërm i shumicës është thjesht një evidentim i standardit kushtetues dhe jo analizë (dhe as përgjigje) e pretendimit të kërkuarit se gjykatat kanë pranuar t’i nënshtrojnë hetimit gjyqësor vetëm provat e akuzës.

4. Shumica nuk i referohet fakteve konkrete lidhur me njoftimin e këtyre dëshmitarëve, të pasqyruara në procesverbalet e seancave gjyqësore të administruara në dosjen gjyqësore. Konkretisht, nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 29.2.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, në kushtet kur shtetasit, që u kërkuan nga prokuroria të thirren me cilësinë e dëshmitarit, jetonin jashtë shtetit, ka ngarkuar Policinë Gjyqësore për njoftimin e tyre me letër rekomande me lajmërim marrje, bazuar në nenin 133/4 dhe 142 të KPP-së.

5. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezulton se në seancën gjyqësore të datës 10.6.2008 gjykata ka riurdhëruar njoftimin e dëshmitarëve okularë, bazuar edhe në parashikimet e





nenit 3/1 të ligjit nr. 9871, datë 11.2.2008 “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, si shtesë e Konventës Europiane për Ekstradimin, të 13 dhjetorit 1957 dhe e Konventës Europiane për Ndihmë Juridike për Çështjet Penale, të 20 prillit 1959, që ka si qëllim të lehtësojë zbatimin e tyre’ “. Në seancën gjyqësore të datës 10.6.2008 është konfirmuar se dëshmitarët nuk kanë marrë njoftim, prandaj, mbi kërkesën e prokurorit, gjykata ka vendosur të përsërisë njoftimin e tyre për t’u paraqitur në seancën e datës 15.7.2008. Njoftimet përsëriten edhe për seancat e datave 09.09.2008 dhe 15.09.2008, por rezultojnë se dëshmitarët nuk janë lajmëruar në përputhje me kërkesat procedurale dhe nuk janë paraqitur. Ky fakt vërtetohet nga shënimi “*adresë e panjohur*” në vulën e postës të vendosur mbi zarfin e dërgimit të njoftimit (fq.171, 187, 191, 195, 208, 210 të procesverbalit).

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka vazhduar gjykimin me leximin e dëshmive të lejueshme, me argumentin se: “*meqenëse dëshmitarët M.C. dhe E.SH. kanë marrë dijeni për seancën e sotme, e dokumentuar me kthim përgjigje nga konfirmimet e postës DHL, ata nuk janë paraqitur, pa asnjë arsye të ligjshme*”.

7. Neni 137 i KPP-së parashikon se personi, i cili njoftohet me letër rekomande me lajmërim marrje, duhet të deklarojë ose të zgjedhë banesën në territorin e shtetit shqiptar. Në rast se një deklarim i tillë nuk bëhet pas njëzet ditësh nga marrja e letrës rekomande, njoftimi bëhet me anën e depozitimit të aktit në sekretari. Mendojmë se shumica nuk merr në analizë përputhshmërinë midis rregullave që duhet të zbatohen për njoftimin e dëshmitarit që ndodhet jashtë shtetit dhe rregullave të zbatuara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, të cilat, siç rezultojnë edhe nga arsyetimi i mësipërm, nuk janë zbatuar rigorozisht. Leximi i deklarimeve të bëra nga shtetasi i huaj, banues jashtë shtetit, mund të bëhet në qoftë se ai është thirrur dhe nuk është paraqitur, ose kur nuk gjendet me gjithë kërkimet e bëra nga policia gjyqësore, si dhe kur refuzon të dëshmojë (neni 369, pika 3 e KPP-së).

8. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë nuk ka respektuar kërkesat e KPP-së për njoftimin e dëshmitarëve okularë që ndodhen jashtë shtetit, duke e deklaruar kërkuesin fajtor dhe dënuar atë në cenim të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Vijimi i procesit gjyqësor me leximin e deklarimeve të shtetasit italian, dëshmitarit okular M.C., i cili banonte jashtë shtetit dhe kishte adresë të njohur në Itali, është në shkelje të kërkesave të mësipërme procedurale dhe përbën cenim të së drejtës për marrjen në mënyrë të ligjshme të provës me dëshmitar.

9. Bazuar në faktet e mësipërme, ne gjyqtarët në pakicë, mendojmë se shumica nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit për mosrespektimin nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të detyrimit për marrjen e provave në mënyrë të ligjshme, edhe pse këto pretendime janë çështje që i përkasin juridiksionit kushtetues. Në rastin konkret, shumica ishte e detyruar të analizonte pretendimin e kërkuesit për mosrespektimin e procedurave të njoftimit me letërporosi me kthim përgjigje, kryesisht të dëshmitarit okular M.C., si provë e akuzës e kërkuar edhe nga mbrojtja.

10. Edhe për sa i përket procesit gjyqësor në Gjykatën e Apelit Durrës, ne jemi të mendimit se shumica nuk i ka marrë aspak në konsideratë pretendimet e kërkuesit, duke dalë në përfundim të gabuar. Shumica i referohet qëndrimit të jurisprudencës kushtetuese se pretendimet për cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nuk pranohen në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (prg.14). Megjithatë, prezumimi apriori i këtij parimi dhe referimi nga ana e shumicës në këtë standard kushtetues është i pavend, nisur nga fakti që Gjykata e Apelit Durrës nuk plotësoi ose korrigjoi mangësitë e procesit gjyqësor në drejtim të garantimit të barazisë së armëve, për faktin se edhe pse pranoi kërkesën e mbrojtjes për përsëritjen e pjesës së shqyrtimit gjyqësor, refuzoi kërkesat e saj për marrjen e provave të mësipërme me arsyetimin se “*vendimet e ndërmjetme të marra nga gjykata e Rrethit Gjyqësor* 10512

*Kavajë janë të bazuara në ligj*” (fq. 178 e procesverbalit të fashikullit gjyqësor). Për më tepër, Gjykata e Apelit nuk i dha përgjigje pretendimeve të kërkuarit lidhur me shkeljet procedurale në njoftimin e dëshmitarëve okularë, që u pasua me leximin e deklarimeve të lejueshme.

11. Përfundimisht, në ndryshim nga sa argumenton shumica, mendojmë se në gjykimin e zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe Gjykatën e Apelit Durrës nuk është respektuar një nga standardet e procesit të rregullt ligjor lidhur me garantimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së dhe, për rrjedhojë, është cenuar e drejta e kërkuarit për një proces të rregullt ligjor.

Anëtar: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha

### VENDIM

**Nr. 58, datë 24.12.2012**

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 9.5.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 14 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Musa Protoduari, Shkëlqim Protoduari përfaqësuar nga avokat Neshat Fana dhe avokat Arenc Berati, me prokurë të posaçme.

**SUBJEKTI I INTERESUAR:** Prokuroria e Përgjithshme, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi, si antikushtetues, i vendimit nr. 31, datë 31.1.2000, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë; vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit); vendimit nr. 933, datë 17.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 631, datë 13.11.2009 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 31, 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 3, 5, 6/1, 6/3 germat “c”, “d” dhe “e” të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 2 dhe 4 të protokollit nr. 7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 28, 29, 30, 39 dhe 42 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

### GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, përfaqësuesin e kërkuarve, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,



## VËREN:

### I

#### ***Rrethanat e çështjes***

1. Mbështetur në aktet ndodhur në dosje, rezulton se Musa Protoduari dhe Shkëlqim Protoduari (kërkuesit) së bashku me disa të pandehur të tjerë kanë qenë të përfshirë në ngjarjen që ndodhi në datën 17 qershor 1997, në Urën Vajguore, në të cilën u shkatërrua një mjet i blinduar i policisë dhe mbetën të vranë katër punonjës të policisë, u plagosën dy të tjerë dhe u vra dhe një civil.

2. Për këtë ngjarje kërkuesit dhe disa të pandehur të tjerë janë hetuar, gjykuar dhe dënuar në mungesë, me vendimin nr. 31, datë 31.1.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (referuar si vendimi nr. 31). Në këtë gjykim kërkuesit kanë qenë të mbrojtur nga një avokat i caktuar kryesisht nga gjykata, i cili nuk e ankimoi këtë vendim.

3. Kundër këtij vendimi është bërë ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë vetëm nga përfaqësuesit e të pandehurve të tjerë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. 222, datë 24.5.2000, vendosi të lërë në fuqi vendimin nr. 31 të sipërpërmendur.

4. Me vendimin nr. 43, datë 26.1.2001, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë la në fuqi vendimin nr. 222 të lartpërmendur.

5. Sipas deklarimeve të kërkuesve, ata kanë qenë jashtë shtetit gjatë zhvillimit të gjykimeve të mësipërme dhe nuk kanë marrë asnjë njoftim për këto gjykime.

6. Kërkuesit shprehen se pasi kanë marrë dijeni për to, me anë të një prokure të hartuar përpara autoriteteve kanadeze, ata kanë caktuar një përfaqësues ligjor për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit kundër vendimit nr. 31 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

7. Me vendimin nr. 274 akti, datë 13.4.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pranoi kërkesën dhe i rivendosi kërkuesit në afat për të bërë ankim kundër vendimit nr. 31.

8. Brenda afateve ligjore, përfaqësuesi i tyre ushtroi të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë e cila, me vendimin nr. 933, datë 17.12.2007, vendosi mospranimin e tij pa i hyrë shqyrtimit të çështjes në themel duke arsyetuar, së pari, se përfaqësuesi nuk gëzonte tagrat e nevojshme për të paraqitur ankim në emër kërkuesve dhe, së dyti, se meqenëse çështja ishte shqyrtuar njëherë në të gjitha shkallët e gjyqimit atëherë vendimi ka marrë formë të prerë që prej vitit 2000, prandaj, në zbatim të nenit 147/2 të Kodit të Procedurës Penale, e drejta për të bërë rivendosje në afat i përket vetëm kërkuesve, pasi të arrestohen dhe të provojnë që nuk kanë pasur dijeni për vendimin gjyqësor.

9. Kundër këtij vendimi përfaqësuesi i kërkuesve ushtroi të drejtën e rekursit pranë Gjykatës së Lartë e cila, me vendimin nr. 00-2009-339(631), të datës 13.11.2009, vendosi mospranimin e tij me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

### II

#### ***Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese***

10. ***Kërkuesit*** pretendojnë se vendimet objekt të kërkesës duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën, për arsye se janë marrë si rrjedhojë e zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor. Këtë pretendim kërkuesit e argumentojnë në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

10.1 *Gjykatat janë kontradiktore në vendimet e tyre.* Kërkuesit janë dënuar pa prova dhe gjykatat janë mbështetur mbi thëniet e dëshmitarit S.V., duke i konsideruar absolutisht të pavlefshme për disa të pandehur dhe të vlefshme për të pandehurit e tjerë.

Gjykata e Apelit gabon kur vlerëson se nuk duhet t'i hyjë shqyrtimit të çështjes në themel për shkak se përfaqësuesit e kërkuesve nuk kanë një prokurë të rregullt.

10.2 *Është cenuar e drejta për mbrojtje.* Mbrojtja e caktuar kryesisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka qenë efektive, pasi nuk ka bërë asnjë kërkesë për prova apo ndonjë kërkesë tjetër në favor të kërkuarve dhe nuk ka argumentuar qëndrimet e saj.

Kërkuarve nuk kanë marrë dijeni, në rrugë zyrtare dhe procedurale, se po hetohen dhe gjykohen. Rrjedhimisht, në mbështetje të jurisprudence së Gjykatës së Strasburgut dhe të vendimit nr. 30/2010 të Gjykatës Kushtetuese, prania e personit, si dhe caktimi i një përfaqësuesi ligjor, të zgjedhur prej tij, në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij është thelbësore për një proces të drejtë.

10.3 *Është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë.* Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 933, datë 17.12.2007, në mënyrë të padrejtë ka refuzuar t'i futet çështjes në themel dhe të marrë në shqyrtim shkaqet a ankimit. Kjo shkelje nuk është rregulluar as nga Gjykata e Lartë në vendimin nr. 00-2009-339(631), të datës 13.11.2009. Gjykata e Apelit duhej t'i kishte hyrë themelit të çështjes, pasi, pas rivendosjes në afat, vendimi nr. 31 është bërë i cenueshëm sepse nuk është më i formës së prerë.

10.4 Marrëveshjet për riatdhësimin e të dënuarve parashikojnë rigjykimin që nga shkalla e parë e të dënuarit në mungesë.

11. *Subjekti i interesuar*, përpara zhvillimit të seancës gjyqësore, i komunikoi me shkrim Gjykatës Kushtetuese prapësimet, që mund të paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijon:

11.1 Kërkuarve nuk legjitimohen për të kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), pasi në këto vendime ata nuk kanë qenë palë.

11.2 Kërkesa përpara Gjykatës Kushtetuese është paraqitur vetëm me firmë të avokatit Neshat Fana, të cilit nuk i është deleguar me prokurë tagri për të paraqitur këtë kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese. Rrjedhimisht, kërkesa është paraqitur nga një person që nuk legjitimohet.

### III

#### *Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese*

##### *1. Mbi legjitimitimin e kërkuarve*

12. Referuar prapësimeve të subjektit të interesuar, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë (Gjykata) vlerëson se duhet të shqyrtojë çështjen e legjitimitimit të kërkuarve.

##### *A. Mbi legjitimitimin e kërkuarve për të pretenduar shfuqizimin e vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit)*

13. Në zbatim të nenit 131, shkronja “f” të Kushtetutës “Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor”. Në zbatim të kësaj dispozite kushtetuese, një kërkuar legjitimohet për të paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese vetëm ato pretendime për të cilat provon se ka shteruar mjetet juridike. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudence e saj, ka vlerësuar se shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efektive për një çështje konkrete (*Vendimet nr. 6, datë 31.3.2006 dhe nr. 27, datë 20.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudence e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “Qufaj kundër Shqipërisë” është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore, që sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

14. Shterimi i mjeteve është parakusht që duhet përmbushur nga ankuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura.



15. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se mbrojtja e kërkuarve, e caktuar kryesisht, nuk ka ankimuar vendimin nr. 31 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shqyrtimin e këtij vendimi Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 222, datë 24.5.2000, dhe Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 43, datë 26.1.2001, janë vënë në lëvizje vetëm mbi ankimin dhe rekursin e të pandehurve të tjerë, të cilët kanë paraqitur vetëm pretendime dhe shkaqe në lidhje me pafajësinë e tyre përkatëse. Rezulton se, në mënyrë që kërkuarët të paraqisnin pretendimet dhe shkaqet në lidhje me pafajësinë e tyre, me vendimin e formës së prerë nr. 274 akti, datë 13.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkuarët janë rivendosur në afat për të ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit nr. 31. Gjykata vëren se kërkuarët e kanë ushtruar këtë të drejtë duke iu drejtuar me ankim Gjykatës së Apelit Tiranë dhe më pas kanë ushtruar të drejtën e rekursit përpara Gjykatës së Lartë.

16. Mbështetur në vendimet objekt kërkesë dhe në aktet ndodhur në dosjen gjyqësore, Gjykata vëren se kërkuarët nuk kanë bërë objekt të rekursit të tyre dhe të debatit gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë çështjen e antikushtetutshmërisë së vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë.

17. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkuarët nuk legjitimohen për të pretenduar përpara saj shfuqizimin e vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) pasi nuk kanë shteruar mjetet e përshtatshme juridike.

#### ***B. Mbi legjitimin e përfaqësuesit të kërkuarve për të paraqitur kërkesën përpara Gjykatës Kushtetuese***

18. Gjykata Kushtetuese konstaton se përfaqësuesit e kërkuarve kanë tagra të plota për të paraqitur, në emër të të përfaqësuarve, kërkesën përpara Gjykatës Kushtetuese.

19. Mbështetur në “Prokurën e Posaçme”, datë 12 janar 2012, hartuar përpara autoriteteve kanadeze dhe vërtetuar pranë Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Kanada, rezulton se përfaqësuesit e kërkuarve, avokati Neshat Fana dhe avokati Arenc Berati, kanë tagra të plota për të përpiluar, nënshkruar dhe paraqitur këtë kërkesë përpara Gjykatës Kushtetuese.

20. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se prapësimi i dytë i subjektit të interesuar është i pabazuar.

#### ***2. Mbi themelin e kërkesës***

21. Gjykata Kushtetuese, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, rikonfirmon qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*vendimi nr. 4, datë 28.2.2006 i Gjykatës Kushtetuese*).

Në vijim të këtij vlerësimi, Gjykata analizon më poshtë pretendimet e ngritura.

#### ***A. Mbi standardin kushtetues sipas së cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara, logjike dhe jo kontradiktore***

22. Gjykata vëren se kërkuarët parashtrojnë përpara saj se është cenuar standardi kushtetues sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara, logjike dhe jo kontradiktore, për shkak se janë dënuar mbi prova të konsideruara absolutisht të pavlefshme për disa të pandehur dhe të vlefshme për të pandehurit e tjerë.

23. Gjithashtu, në seancë gjyqësore (fq. 3 e procesverbalit), përfaqësuesit e kërkuarve parashtrojnë se standardi i mësipërm është cenuar edhe për shkak se Gjykata e Apelit Tiranë, në 10516

vendimin nr. 933, datë 17.12.2007, ka mbajtur një qëndrim jo logjik, duke konsideruar të parregullt një prokurë e cila është në fakt e rregullt.

24. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradikcion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik. Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij.

25. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Vendimi që përmban ose lejon kontradiktën logjike, cenon rëndë dhënien e drejtësisë. Ai nuk mund të jetë i kuptueshëm dhe bindës dhe për pasojë nuk mund të zbatohet në praktikë. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore (*shih vendimin e GJK nr. 33, datë 8.12.2005*).

26. Gjykata vëren se e drejta e kërkuarve për të paraqitur ankim kundër vendimit nr. 31, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, është rivendosur në afat me vendimin e formës së prerë nr. 274 akti, datë 13.4.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga shqyrtimi i dosjes gjyqësore (fq. 6) Gjykata vëren se me prokurën e datës 29 nëntor 2006, hartuar përpara autoriteteve kanadeze (vërtetuar më datë 4 dhjetor 2006 pranë ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Otava, me shkresën nr. D91-06 Prot.), kërkuarët i kanë deleguar disa tagra avokatit Arenc Berati, ndër të cilat figuron e drejta për “[...]të bërë ankim kundër çdo vendimi të marrë në kundërshtim me interesat e tyre nga gjykatat shqiptare, në të gjitha shkallët e gjykimit [...]”. Mbështetur në këtë prokurë, përfaqësuesi i kërkuarve paraqiti përpara Gjykatës së Apelit Tiranë ankim kundër vendimit nr. 31. Nga analiza e vendimit nr. 933, datë 17.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykata Kushtetuese vëren se ky ankim nuk është shqyrtuar në themel, me arsyetimin se përfaqësuesve nuk u ishte deleguar me prokurë e drejta për të bërë ankim.

27. Gjykata vëren se kërkuarët i janë drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë, duke pretenduar, ndër të tjera, se ky vlerësim i Gjykatës së Apelit Tiranë rreth prokurës ishte jo logjik dhe kontradiktor. Gjykata e Lartë rezulton se nuk i ka dhënë përgjigje në vendimin e saj nr. 00-2009-339(631), të datës 13.11.2009, këtij pretendimi.

28. Gjykata Kushtetuese vlerëson se në përputhje me nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale ishte detyrë e Gjykatës së Lartë që të verifikonte dhe shqyrtonte këtë pretendim, duke i dhënë një përgjigje të arsyetuar.

29. Në kushtet kur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pa arsyetuar në vendimin e tij pse pretendimet e kërkuarve nuk përmbajnë shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Kushtetuese, referuar rolit të Gjykatës së Lartë në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, nuk mund të investohet në ekzaminimin e pretendimeve të kërkuarve lidhur me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, pa u shprehur më parë Gjykata e Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do të ishte në kundërshtim me parimin e subsidiaritetit (komplementaritetit), duke e nxjerrë Gjykatën Kushtetuese jashtë funksionit të saj.



### ***B. Mbi cenimin e së drejtës së mbrojtjes***

30. Kërkuesit pretendojnë se u është cenuar e drejta e mbrojtjes, për shkak të mungesës së njoftimit se ata ishin objekt të një hetimi dhe gjykimi penal, si dhe për shkak të mosgarantimit të një mbrojtjeje efektive nga ana e mbrojtësit të caktuar kryesisht.

#### ***i. Mbi cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të mungesës së njoftimeve***

31. Gjykata Kushtetuese vëren se kërkuesit janë hetuar, gjykuar dhe dënuar në mungesë.

32. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e një personi të akuzuar, për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të akuzave të ngritura kundër tij, është thelbësore për një proces të drejtë. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm praninë fizike, por edhe aftësinë për të dëgjuar dhe ndjekur procedimet, për të kuptuar provat dhe argumentet, për të orientuar përfaqësuesit ligjorë dhe për të dhënë fakte. Edhe pse nuk është absolute, e drejta e çdokujt, të akuzuar për një vepër penale, për t'u mbrojtur efektivisht nga një mbrojtës ligjor, është një nga kriteret kryesore të gjykimit të drejtë. Një person i akuzuar penalisht nuk e humb këtë të drejtë thjesht për faktin se ai nuk ndodhet vetë personalisht në gjyq (*shih vendimin nr. 45, datë 10.10.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Sipas praktikës së kësaj Gjykate, si dhe të GJEDNJ-së, është detyrë e autoriteteve shtetërore përkatëse që të njoftojnë në mënyrë rigoroze, konform kërkesave procedurale, të pandehurin ndaj të cilit ka filluar një proces penal, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ka hequr dorë me vullnetin e tij të lirë nga pjesëmarrja në gjykim. Vërtetimi i këtyre fakteve, sipas Gjykatës, është detyrë e organeve kompetente. Me këtë detyrim të organeve përkatëse shtetërore, për të njoftuar në mënyrë rigoroze të pandehurin dhe për të provuar se ai i fshihet drejtësisë, është e lidhur e drejta e tij për të marrë pjesë në gjykim, si dhe e drejta e gjykatës për të vendosur për gjykimin e tij në mungesë, kur janë respektuar në mënyrë rigoroze dispozitat për njoftimin (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 45, datë 10.10.2011*).

34. Gjykata vëren, mbështetur në vendimet objekt kërkese, se ngjarja për të cilën kërkuesit janë dënuar, është zhvilluar gjatë trazirave civile që ndodhën në vitin 1997. Pak kohë përpara kësaj ngjarjeje rezultojnë të jenë kryer sulme me armë ndaj banesës së kërkuesve dhe menjëherë pas ngjarjes banesa e tyre është pushtuar nga një turmë njerëzish. Kërkuesit pretendojnë se për shkak të këtyre ngjarjeve janë larguar menjëherë nga Shqipëria dhe për këtë arsye nuk mund të kishin dijeni për procesin që po zhvillohej ndaj tyre në mungesë.

35. Gjykata vëren se kërkuesit, gjatë gjykimit të zakonshëm pas rivendosjes në afat të së drejtës së ankimit, kanë ngritur, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, pretendimin se janë hetuar, gjykuar dhe dënuar, edhe pse në asnjë rast nuk janë njoftuar sipas rregullave procedurale. Kërkuesit i janë referuar faktit që në dosjen gjyqësore nuk ndodhet asnjë dokument në lidhje me njoftimin e tyre.

36. Gjykata vlerëson se edhe pse ky pretendim i kërkuesve përbën një aspekt të rëndësishëm kushtetues të procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë nuk është shprehur në lidhje me të. Në këto kushte, Gjykata, referuar rolit të Gjykatës së Lartë në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, çmon se ajo duhet të shprehej për qëndrimin e saj lidhur me pretendimin e mësipërm.

#### ***ii. Mbi cenimin e të drejtës për një mbrojtje efektive***

37. Kërkuesit pretendojnë se gjatë gjykimit të çështjes së tyre nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbrojtësi i caktuar kryesisht nga ajo gjykatë nuk u ka garantuar atyre një mbrojtje efektive.

38. Gjykata vlerëson të nevojshme të ritheksojë se funksioni i saj, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, është që të bëjë gjykimin përfundimtar të kërkesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

39. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të

përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*vendimet nr. 6, datë 31.3.2006 dhe nr. 27, datë 20.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “Qufaj kundër Shqipërisë” është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore, që sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

40. Shterimi i mjeteve është parakusht që duhet përmbushur nga ankuesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura.

41. Gjykata vëren, mbështetur në dosjen gjyqësore, se në rastin në shqyrtim kërkuesit nuk kanë ngritur këtë pretendim në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë.

42. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet ligjore që kishin në dispozicion për të rivendosur këtë të drejtë dhe, për pasojë, nuk mund të paraqesin për shqyrtim këtë pretendim përpara saj.

### **C. Mbi cenimin e së drejtës për akses në gjykatë**

43. Gjykata Kushtetuese i ka dhënë plotësisht substancë së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës (e drejta e aksesit). Gjykata ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme se neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se “*Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës është një nga aspektet e të drejtës për gjykim, e sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës. Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor*” (shih vendimet e GJK nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 4, datë 23.2.2011).

44. E drejta e aksesit në gjykatë mund t’i nënshtrohet kufizimeve deri në atë masë sa ato të mos cenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës (vendimi i GJK nr. 18, datë 8.7.2009). Megjithatë, e drejta e aksesit nuk konsiderohet e mohuar apo e kufizuar nëse vetë sjellja apo veprimet e subjektit janë në origjinë të mohimit apo kufizimit.

45. Gjykata në rastin në shqyrtim konstaton se Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin nr. 933, datë 17.12.2007, ka vlerësuar se nuk duhet t’i hyjë shqyrtimit të çështjes në themel dhe, për pasojë, ankimi i kërkuesve nuk duhet pranuar për shkak se është paraqitur nga një përfaqësues pa tagra. Gjykata, referuar rekursit të paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, vëren se kërkuesit kanë ngritur pretendimin se kjo vendimmarrje e Gjykatës së Apelit Tiranë u ka cenuar të drejtën kushtetuese të aksesit në Gjykatë, për shkak se përfaqësuesi gëzonte tagra të plota për të paraqitur ankimin. Gjykata Kushtetuese, mbështetur në standardet kushtetuese të sipërpërmendura, vëren se pretendimi i kërkuesit mbi arsyetimin e Gjykatës së Apelit, edhe pse përfshihet në parashikimet e nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, nuk rezulton të ketë marrë një përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë.

46. Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesve përbën një aspekt të rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor dhe për këtë arsye rithekson se ishte detyrë e Gjykatës së Lartë që të shprehej me një arsyetim të detajuar pse ky pretendim, në kundërshtim me sa parashtronin kërkuesit, nuk përfshihej tek shkaqet e parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale dhe procesi është i rregullt nga pikëpamja kushtetuese.





***D. Mbi pretendimin se marrëveshjet për riatdhesimin e të dënuarve parashikojnë rigjykimin që nga shkalla e parë e të dënuarit në mungesë***

47. Në përputhje me nenin 131/f të Kushtetutës individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese vetëm për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese për proces të rregullt ligjor.

48. Gjykata thekson se zbatimi ose jo i një marrëveshjeje ndërkombëtare nuk përbën në vetvete cenim të së drejtës së një individi për proces të rregullt ligjor. Individi, në kuptimin e dispozitës kushtetuese të sipërpërmendur, duhet të përcaktojë standardet e procesit të rregullt ligjor që pretendon se i janë cenuar. Gjykata vëren se kërkuesit nuk kanë identifikuar standardin kushtetues të procesit të rregullt ligjor që sipas tyre u është cenuar nga moszbatimi i marrëveshjeve për riatdhesimin e të dënuarve.

49. Për pasojë, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk e kanë argumentuar këtë pretendim në nivel kushtetues.

50. Në përfundim, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, thekson qëndrimin e saj se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Prandaj Gjykata e Lartë për pretendimet e ngritura nga kërkuesi duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to, në funksion të rolit të saj në kontrollin dhe respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta.

51. Gjykata vlerëson se në kushtet kur Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim, pa arsytuar në vendimin e tij pse pretendimet e kërkuesit nuk përmbajnë shkaqet e parashikuara në nenin 432 të KPP-së, apo pse procesi gjyqësor ndaj tij, në kundërshtim me sa pretendon kërkuesi, është i rregullt nga pikëpamja kushtetuese, Gjykatës Kushtetuese nuk i mbetet gjë tjetër veçse të shprehet vetëm për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit përkatës të Gjykatës së Lartë, i cili nuk i ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit.

52. Për rrjedhojë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

**PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

**VENDOSI:**

- Shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të vendimit nr. 631, datë 13.11.2009 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit).<sup>1</sup>
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.
- Rrëzimin për kërkimet e tjera.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

Anëtare kundër: Vitore Tusha

<sup>1</sup> Kryetari dhe gjyqtarët S. Berberi dhe F. Hoxha janë shprehur me Mendim Paralel.

## MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese ka pranuar pjesërisht kërkimet shtruar para saj, duke shfuqizuar si të papajtuëshëm me Kushtetutën vendimin nr. 631, datë 13.11.2009 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, me arsyetimin se respektimi i parimit të subsidiaritetit (komplementaritetit) imponon që Gjykata Kushtetuese duhet të investohet me shqyrtimin e pretendimeve të kërkuesve, vetëm pasi të jetë shprehur më parë Gjykata e Lartë. Për pasojë, Gjykata e Lartë duhet të investohej në ekzaminimin e pretendimeve të ngritura në rekurs dhe të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me to.

2. Në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës për shfuqizimin e vendimit nr. 631, datë 13.11.2009 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), por vlerësojmë se edhe pretendimi për shfuqizimin e vendimit nr. 933, datë 17.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkak se ka cenuar të drejtën e aksesit, duhet pranuar, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel.

3. Gjykata Kushtetuese është shprehur se neni 42, paragrafi 2 i Kushtetutës parashikon se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Gjykata ka vlerësuar edhe më parë se *“Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i të drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 7, datë 11.3.2008).*

4. Në vendimin nr. 933, datë 17.12.2007, Gjykata e Apelit (fq. 6 e vendimit) ka vlerësuar se *“nuk duhet t’i hyjë shqyrtimit të çështjes”* për faktin se ankimi i paraqitur nga avokati përfaqësues i kërkuesve *“është një ankim për të cilin ai [avokati] nuk ka të drejtë ta paraqesë. Sipas prokurës të lëshuar nga të pandehurit [kërkuesit] rezulton, se ai ka të drejtë të përfaqësojë të pandehurit vetëm me objekt rishikim vendimi para gjykatave shqiptare dhe asnjë të drejtë tjetër. Kështu që shihet qartë që ankimi është bërë nga një person i palegjitimuar”*.

5. Në mendimin tonë, arsyetimi i mësipërm i Gjykatës së Apelit u ka mohuar kërkuesve të drejtën për të pasur një akses substantiv në gjykatë. Mbështetur në prokurën në fjalë, vërejmë se Gjykata e Apelit Tiranë ka bërë një lexim haptazi të gabuar të saj. Referuar kësaj prokure të përgjithshme të datës 29.11.2006, bërë përpara autoriteteve kanadeze, rezulton se (paragrafi 6) kërkuesit i kanë dhënë *“tagra të plota që të paraqesë kërkesa, padi ose kundërpadi, të bëjë ankim për çdo vendim të marrë në kundërshtim me interesat tona nga gjykatat shqiptare në të gjitha shkallët e gjyqimit të përcaktuara në ligj, nga organet e administratës shtetërore, apo çdo person juridik ose privat”*.

6. Më tej, mendojmë gjithashtu se arsyetimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është kontradiktor dhe jo logjik. Gjykata Kushtetuese (shih vendimin nr. 33, datë 8.12.2005) është shprehur se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Arsyetimi i vendimit nuk duhet të përmbajë asnjë kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Pjesa arsyetuese duhet të jetë e mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese.

7. Në mendimin tonë, Gjykata e Apelit, kur konstaton në vendim (paragrafi i fundit i faqes 5) se *“Të pandehurit [...] me prokurën e tyre të lëshuar në dt. 29.11.2006, hartuar përpara autoriteteve kanadeze, i kanë dhënë të drejtë avokatëve të tyre të marrin dijeni në lidhje me vendimin dhe të bëjnë ankim”*, nuk nxjerr konkluzionet që imponohen logjikisht nga ky konstatim, pasi shprehet se (fq. 6 e vendimit) *“Sipas prokurës së lëshuar nga të pandehurit [kërkuesit] rezulton, se ai [avokati] ka të drejtë të përfaqësojë të pandehurit vetëm me objekt rishikim vendimi para gjykatave shqiptare dhe asnjë të drejtë tjetër”*. Vërejmë se ekziston një kontradiksion logjik ndërmjet këtyre dy konstatimeve për shkak se Gjykata e Apelit Tiranë nuk mund që për të njëjtën prokurë të



konstatojë se avokatëve u është deleguar e drejta për të bërë ankim dhe më tej të konstatojë se, po kjo prokurë, i ka deleguar avokatëve të drejta përfaqësimi vetëm në lidhje me procese për rishikim vendimi.

8. Për sa parashtruar më sipër, jemi të mendimit se Gjykata e Apelit, me një arsyetim haptazi të gabuar, kontradiktor dhe jologjik i ka mohuar kërkuesve të drejtën e aksesit në Gjykatë. Për këtë arsye, mendojmë se vendimi nr. 933, datë 17.12.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë duhet të shfuqizohej për shkak se është marrë si pasojë e një procesi jo të rregullt ligjor.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Sokol Berberi

### MENDIM PAKICE

Jam kundër qëndrimit të shumicës, lidhur me pranimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesit Musa Protoduari dhe Shkëlqim Protoduari për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për arsyet si vijon:

1. Kërkuesit, duke pretenduar se procesi gjyqësor i themelit dhe ai i rivendosjes në afat të ankimit janë zhvilluar në shkelje të standardeve të procesit të rregullt ligjor, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të dhëna gjatë të dy proceseve gjyqësore. Konkretisht, kërkuesit kundërshtojnë vendimet nr. 31, datë 31.1.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), të cilat janë marrë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në përfundim të shqyrtimit në themel të çështjes penale në ngarkim të tyre dhe, në përfundim, Musa Protoduari është deklaruar fajtor për veprat penale të “krijimit dhe marrjes pjesë në bandat e armatosura”, të “vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, të “heqjes së paligjshme të lirisë” dhe, në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, është dënuar me burgim të përjetshëm, kurse Shkëlqim Protoduari është deklaruar fajtor për veprat penale të “krijimit dhe marrjes pjesë në bandat e armatosura”, të “heqjes së paligjshme të lirisë” dhe, në zbatim të nenit 55 të KP-së, është dënuar me 13 vjet burgim. Gjatë këtij procesi gjyqësor kërkuesit janë hetuar, gjykuar e dënuar në mungesë dhe kanë qenë të përfaqësuar nga mbrojtës i caktuar kryesisht nga gjykata.

2. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kërkuesit janë larguar gjatë trazirave të vitit 1997 dhe janë rezidentë në Kanada. Ata kanë marrë dijeni për procesin gjyqësor penal të përfunduar *in absentia*, për veprat penale në ngarkim dhe masat përkatëse të dënimit në fund të vitit 2006 dhe, në datën 29.11.2006, kanë hartuar një prokurë të përgjithshme duke caktuar mbrojtësin e tyre. Ky i fundit, në datën 11.12.2006 ka paraqitur kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 274, datë 13.4.2007. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 933, datë 17.12.2007, ka vendosur mospranimin e ankimit të kërkuesve, duke u bazuar në dy argumente, së pari, “Gjykata nuk mund t’i hyjë shqyrtimit të çështjes për faktin se ankimi është paraqitur nga avokati ...i cili, sipas prokurës, ka të drejtë të përfaqësojë të pandehurit vetëm me objekt rishikim vendimi. Kështu, shihet qartë se ankimi është bërë nga një person i palegjitimuar” dhe, së dyti: “kjo çështje është shqyrtuar njëherë në të gjitha shkallët e gjykimit dhe vendimi ka marrë formë të prerë prej vitit 2000”. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2009-339(631), datë 13.11.2009, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesit me arsyetimin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale.

#### A. Në lidhje me legjitimitimin

3. Shumica, paraprakisht, analizon legjitimitimin e kërkuesve për të vënë në lëvizje juridiksionin kushtetues lidhur me procesin gjyqësor që ka shqyrtuar çështjen në themel gjatë periudhës kohore 2000-2001. Shumica konstaton se kërkuesit nuk kanë bërë objekt të rekursit të tyre

dhe të debatit gjyqësor pranë Gjykatës së Lartë çështjen e antikushtetutshmërisë së vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë. Bazuar në këtë konsideratë, shumica arrin në përfundimin se kërkuessit nuk legjitimohen për të pretenduar përpara saj shfuqizimin e vendimit nr. 222, datë 24.5.2000 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 43, datë 26.1.2001 të Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit), pasi nuk kanë shteruar mjetet e përshtatshme juridike.

4. Në jurisprudencën e saj të vazhdueshme, Gjykata Kushtetuese rithekson se çështja e legjitimitimit të kërkuessit lidhet drejtpërdrejt me inicimin e një procesi kushtetues. Individit, në kuptim të neneve 131, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “g” dhe pika 2 të Kushtetutës, mund të vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Kërkesat e individit për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes, rregull ky i parashikuar nga neni 30, pika 2 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

5. Kërkesat e mësipërme janë trajtuar nga jurisprudenca kushtetuese si elemente përbërëse të legjitimitimit të kërkuessit, konkretisht, legjitimitimi *ratione personae*, *ratione materiae* dhe *ratione tempore*. Respektimi i afatit kohor të parashikuar nga ligji organik i Gjykatës Kushtetuese është elementi i parë që duhet vlerësuar për legjitimitimin e kërkuessit, çfarë nënkupton se edhe në rast se një individ legjitimohet *ratione personae*, pasi pretendimet e tij përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134/g të Kushtetutës, *ratione materiae*, pasi pretendimet e kërkuessit janë *prima facie* në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese, nëse kërkesa paraqitet jashtë afatit 2-vjeçar, atëherë kërkuessi nuk legjitimohet të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues.

6. Në vështrim të sa më sipër, mendoj se arsytimi i shumicës jo vetëm bie ndesh me qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese lidhur me kërkesat që duhet të plotësojë paraprakisht kërkuessi për t’u legjitimuar, por është edhe kontradiktor me rrethanat e çështjes. Edhe pse shumica parashtron si fakt të provuar se hetimi, gjykimi dhe dënimi i kërkuessve është zhvilluar *in absentia* dhe në prani të mbrojtësit kryesisht, arrin në përfundimin se ata nuk kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion për të kundërshtuar vendimet gjyqësore të dhëna gjatë shqyrtimit në themel të akuzës penale.

7. Mendoj se arsytimi i shumicës është tërësisht i gabuar dhe jo në përputhje me standardet e gjykimit të të pandehurve në mungesë, kur këta të fundit janë mbrojtur nga mbrojtës kryesisht. Të arrish në përfundimin se kërkuessit e gjykuar në mungesë dhe të mbrojtur nga mbrojtës i caktuar kryesisht, nuk kanë shteruar mjetet e ankimit për faktin se nuk është bërë ankim në emër të tyre në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, edhe pse procesi në këto gjykata është zhvilluar edhe ndaj kërkuessve, do të thotë t’u kërkuessit të gjykuarve, në mungesë, të ushtrojnë ankim ose rekurs kundër një vendimi të marrë në përfundim të një procesi gjyqësor për të cilin nuk kanë dijeni. Po ashtu, do të thotë që të drejtën e ankimit, e cila është e drejtë kushtetuese ngushtësisht vetjake e të pandehurit, t’ia njohësh mbrojtësit të caktuar kryesisht, tagrat përfaqësuese të të cilit janë të kufizuara, për sa kohë nuk ka shprehje të vullnetit të të pandehurit personalisht, apo përmes familjarëve të tij.

8. Shumica, para së gjithash, duhet t’i jepte përgjigje të argumentuar pyetjes nëse në rastet e pretendimit për padijeni të procesit gjyqësor të zhvilluar, a është e mundur të kërkuessit shterim mjetesh apo duhet të kontrollohet respektimi i rregullave dhe kriterëve mbi të cilat duhet të zhvillohet gjykimi në mungesë, për faktin se provueshmëria e dijenisë ose padijenisë së të gjykuarit në mungesë janë përcaktuese të shterimit ose jo të mjeteve juridike në dispozicion.

9. Kriteret e gjykimit në mungesë të të akuzuarit, të përcaktuara nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës në Rezolutën (75), u rekomandojnë shteteve anëtare që të mbajnë parasysh nëntë rregulla minimale: i) askush nuk duhet të gjykohej pa pasur një thirrje për gjyq në kohë; ii) kjo thirrje për gjyq duhet të ketë të sanksionuara edhe pasojat nëse i akuzuari nuk vjen në gjykim;



iii) kur gjykata vëren se edhe pse i akuzuari është njoftuar dhe nuk është paraqitur, ajo, nëse çmon se prania e tij në proces është e pazëvendësueshme ose beson se i akuzuari është penguar të paraqitet, duhet të vendosë shtyrjen e procesit; iv) i akuzuari nuk duhet të gjykohet në mungesë, nëse është e mundur të transferohen procedimet te një shtet tjetër ose të aplikohet për ekstradim; v) kur i akuzuari gjykohet në mungesë, provat duhet të merren në mënyrë të zakonshme dhe mbrojtja duhet të ketë të drejtë të ndërhyjë; vi) një vendim gjykate, i dhënë në mungesë, duhet t'i njoftohet personit sipas rregullave për njoftimet dhe marrjes dijeni brenda afatit të parashikuar për apelim. Ky afat duhet të fillojë që nga dita e marrjes dijeni efektivisht të personit, përveçse kur ai qëllimisht i fshihet drejtësisë; vii) çdo personi të gjykuar në mungesë, duhet t'i jepet e drejta për apelim, me çdo lloj mjeti ligjor që do t'i ishte dhënë sikur ai të ishte i pranishëm; viii) për personin e gjykuar në mungesë, të cilit nuk i është bërë njoftimi në mënyrën e duhur, duhet të ketë një mjet ankimi që t'i mundësojë atij shfuqizimin e vendimit; ix) një person i gjykuar në mungesë, por që njoftimi i është bërë në rregull, duhet të ketë të drejtën e një rigjykimi në mënyrën e zakonshme, nëse ai mund të provojë mungesën e tij para gjykatës për arsye të pavarura nga vullneti i tij.

10. Ndryshe nga sa argumenton shumica, mendoj se shkak i moslegjitimitit të kërkuesve nuk është mosshkrimi i mjeteve juridike të përshtatshme, por moslegjitimimi i tyre *ratione tempore* për shfuqizimin e vendimeve të procesit gjyqësor të shqyrtimit të çështjes në themel, të marra në periudhën kohore 2000 – 2001. Ndonëse kërkuesit janë vënë në dijeni për procesin gjyqësor në vitin 2006, kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese në datën 28.9.2011, pra jashtë afatit 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30, pika 2 e ligjit organik.

#### *B. Në lidhje me themelin*

11. Ndaj mendim të ndryshëm me shumicën edhe në lidhje me themelin e çështjes. Nga përmbajtja e vendimit konstatohet se shumica, pasi analizon se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës së mbrojtjes për shkak të mungesës së njoftimeve, të standardit kushtetues të arsyesimit të vendimit, të së drejtës së aksesit në gjykatë, arrin në përfundimin se: *“pretendimet e parashtruara nga kërkuesit duhet të ishin marrë në konsideratë nga Gjykata e Lartë, pasi referuar rolit të saj në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, ajo duhet të shprehej për qëndrimin e saj lidhur me këto pretendime. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe, si i tillë, duhet të shfuqizohet”*.

12. Shumica është përpjekur t'u japë përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruara nga mbrojtësi i kërkuesve, por në mënyrë të gabuar nuk bën, paraprakisht, dallimin midis pretendimeve që kanë të bëjnë me procesin e zgjidhjes së çështjes në themel dhe pretendimeve që kanë të bëjnë me procesin e rivendosjes në afat të ankimit. Nga pikëpamja kushtetuese, analizimi nga ana e shumicës i pretendimeve që kanë të bëjnë me procesin e themelit si e drejta e mbrojtjes për shkak të mungesës së njoftimeve dhe e drejta e mbrojtjes efektive, është i gabuar, pasi siç e kam shprehur edhe më lart, kërkuesit nuk legjitimohen *ratione tempore*.

13. Shumica është kontradiktore në arsyetimin e vendimit për faktin se merr në shqyrtim pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes gjatë gjykimit në mungesë, edhe pse ky pretendim ka të bëjë me procesin e gjykimit në themel të çështjes, për kundërshtimin e të cilit paraprakisht ka dalë në përfundimin se kërkuesit nuk kanë shteruar mjetet juridike. Shumica vlerëson se *“ky pretendim i kërkuesve përbën një aspekt të rëndësishëm kushtetues të procesit të rregullt ligjor ... në këto kushte, referuar rolit të Gjykatës së Lartë në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, çmon se ajo duhet të shprehej për qëndrimin e saj lidhur me pretendimin e mësipërm”*.

14. Gjithashtu, shumica, gjatë shqyrtimit të pretendimit për cenimin e standardit kushtetues të arsyesimit, konstaton se *“nga analiza e vendimit nr. 933, datë 17.12.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë, Gjykata Kushtetuese vëren se ky ankim nuk është shqyrtuar në themel me arsyetimin se përfaqësuesve nuk u ishte deleguar me prokurë e drejta për të bërë ankim.”* Ky konstatim ka qenë i

mjaftueshëm për shumicën për të dalë në përfundimin, aspak të argumentuar, se vendimi i Gjykatës së Apelit nuk ka respektuar standardin e arsytimit dhe se “... në përputhje me nenin 432 të KPP-së ishte detyrë e Gjykatës së Lartë që të verifikonte dhe shqyrtonte këtë pretendim, duke i dhënë një përgjigje të arsyetuar”.

15. Po ashtu, gjatë shqyrtimit të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit nga Gjykata e Apelit, shumica argumenton se: “... Gjykata e Apelit Tiranë, në vendimin nr. 933, datë 17.12.2007 ka vlerësuar se nuk duhet t’i hyjë shqyrtimit të çështjes në themel dhe, për pasojë, ankimi i kërkuar nuk duhet pranuar për shkak se është paraqitur nga një përfaqësues pa tagra. Gjykata, referuar rekursit të paraqitur pranë Gjykatës së Lartë, vëren se kërkuarist kanë ngritur pretendimin se kjo vendimmarrje e Gjykatës së Apelit Tiranë u ka cenuar të drejtën kushtetuese të aksesit në Gjykatë për shkak se përfaqësuesi gëzonte tagra të plota për të paraqitur ankimin. Gjykata Kushtetuese, mbështetur në standardet kushtetuese të sipërpërmendura, vëren se pretendimi i kërkuarist mbi arsytimin e Gjykatës së Apelit, edhe pse përfshihet në parashikimet e nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, nuk rezulton të ketë marrë një përgjigje të arsyetuar nga Gjykata e Lartë” (shih prg. 45).

16. Përfundimi i mësipërm i shumicës lidhur me cenimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor dhe të së drejtës së aksesit bazohet vetëm në vlerësimin e elementeve të prokurës, veçanërisht të tagrave të përfaqësimit të parashikuara shprehimisht në të. Shumica nuk i evidenton faktet plotësisht, sepse arsytimi i Gjykatës së Apelit për rrëzimin e kërkesës për rivendosje në afat bazohet edhe në një argument tjetër ligjor të paevidentuar prej shumicës, konkretisht, se: “... mospranimi i ankimit duhet të vendoset edhe për faktin tjetër se kjo çështje është shqyrtuar njëherë në të gjitha shkallët e gjykimit dhe vendimi ka marrë formë të prerë që nga viti 2000”.

17. Po ashtu, shumica është kontradiktore në arsytimin e vendimit për faktin se merr në shqyrtim edhe pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes gjatë gjykimit në mungesë, edhe pse ky pretendim ka të bëjë me procesin e gjykimit në themel të çështjes, për kundërshtimin e të cilit paraprakisht ka dalë në përfundimin se kërkuarist nuk kanë shteruar mjetet juridike. Shumica vlerëson se “ky pretendim i kërkuarist përbën një aspekt të rëndësishëm kushtetues të procesit të rregullt ligjor ... në këto kushte, referuar rolit të Gjykatës së Lartë në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, çmon se ajo duhet të shprehej për qëndrimin e saj lidhur me pretendimin e mësipërm”.

18. Të arrish në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet dhe çështja duhet të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë, do të thotë, në vlerësimin e shumicës, që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të mbajë një qëndrim i cili bie ndesh me praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, konkretisht me vendimin unifikues nr. 1, datë 20.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Në referim të këtij të fundit, pasi çështja është shqyrtuar në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë, në mungesë të të pandehurit, ky i fundit ose mbrojtësi i tij nuk mund të kërkojë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim për të cilin Kolegji është shprehur njëherë, me pretendimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit ose se ankimi (rekursi) është paraqitur nga bashkëpandehurit e tjerë dhe jo nga vetë kërkuarist.

19. Rishqyrtimi i rekursit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në kushtet kur ai është shprehur njëherë në lidhje me mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala, jo për shkak të paraqitjes së tij tej afatit ligjor (neni 420 i KPP-së), por për shkak të mosekzistencës së shkaqeve të parashikuara nga neni 432 i KPP-së, bie ndesh me parimin e *res judicata* (gjëja e gjykuar), pasi i njëjti Kolegji nuk mund të shqyrtojë dhe shprehet dy herë në lidhje me rekursin e paraqitur nga e njëjta palë kundër të njëjtit vendim të gjykatës së apelit.

20. Bazuar sa më sipër, në rastin në shqyrtim, shumica duhet të pranonte se të pandehurit Protoduari, janë në kushte objektivisht të pamundura për të kërkuar rivendosjen në afat të së drejtës



për të ushtruar rekurs ndaj të njëjtit vendim për të cilin Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur njëherë mbi rekursin e paraqitur nga bashkëtepandehurit e tjerë. Shumica, jo vetëm nuk arrin në një përfundim të tillë, por përkundrazi, në shkelje të standardeve të konsoliduara të jurisprudencës kushtetuese arrin në përfundime të gabuara si për sa i përket trajtimit të pretendimeve ashtu edhe zgjidhjes përfundimtare të çështjes.

21. Trajtimi nga jurisprudenca kushtetuese e kësaj Gjykate i rasteve të ngjashme me çështjen objekt shqyrtimi, rëndësia që jurisprudenca e GJEDNJ-së u kushton gjykimeve në mungesë, unifikimi i standardeve ligjore nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë mbi të tilla problematika, janë arsyt kryesore mbi bazën e të cilave vlerësoj se paraqitja e kërkesës për rivendosje në afat, në rastin konkret, nuk është mjeti efektiv dhe i përshtatshëm. Megjithatë, ky vlerësim nuk u mohon aspak kërkuarve Protoduari mundësinë për të rivendosur të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor që ata pretendojnë se u është cenuar për shkak të gjykimit në mungesë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

22. Kërkesa për rivendosjen në afat, e parashikuar në nenin 147 të KPP-së, nuk kundërshton, në thelb, vendimin e gjykatës në lidhje me ekzistencën ose jo të shkaqeve të mospranimit të ankimit. Kërkesa për rivendosje në afat është një mjet procedural që u mundëson subjekteve të caktuara të ushtrojnë të drejtën e ankimit, të cilën nuk kanë pasur mundësi ta ushtrojnë brenda afateve ligjore për shkak të rastit faktor ose të forcës madhore. Në kuptim të këtij neni, kërkesa për rivendosje në afat duhet të tregojë se pavarësisht se subjekti ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm, depozitimi i ankimit brenda afatit ligjor nuk ka qenë i mundur për shkaqe që nuk vareshin prej vullnetit tij. Në rast se këto shkaqe konsiderohen të ligjshme prej gjykatës që shqyrton kërkesën, ajo i mundëson palës që të ushtrojë ankim duke kundërshtuar vendimin dhe parashtruar shkaqet për të cilat ajo mendon se vendimi nuk është në zbatim të ligjit. Gjykata, e cila shqyrton ankimin e rivendosur në afat, nuk kufizohet në shqyrtimin e elementeve formale të ankimit, përveç atyre për të cilat është bërë rivendosja në afat, por shqyrton dhe shprehet lidhur me thelbin e pretendimeve të palës, duke vendosur përfundimisht sipas përcaktimeve të nenit 428 ose 441 të KPP-së (*shih vendimin unifikues nr. 1, datë 20.1.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*).

23. GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj shprehet se kërkesa për rivendosje në afat të ankimit nga të gjykuar në mungesë duhet të konsiderohet e hapur ndaj dyshimeve, nisur nga vendimet e gjykatave kombëtare në çështje të tjera ku kërkesa e të akuzuarit për rivendosje në afat është rrëzuar, *inter alia*, me arsyetimin se i akuzuari, gjatë seancave gjyqësore *in absentia*, mbrohej nga mbrojtës i zgjedhur nga familjarët. Për rrjedhojë, GJEDNJ-ja nuk është e bindur se një kërkesë për rivendosje në afat, kur aplikanti është përfaqësuar nga mbrojtësi i zgjedhur nga familjarët, do të kishte perspektiva reale suksesi. Paraqitja e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese është një mjet efektiv për të kundërshtuar dënimin *in absentia* (*shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen "Shkalla kundër Shqipërisë", paragrafët 59-62*).

24. Në vështrim të sa më sipër, jam e mendimit se paraqitja, vetëm brenda afatit ligjor, e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese do të përbente për kërkuarët mjetin efektiv, që do t'i siguronte akses në gjykimin kushtetues për të parashtruar pretendimet lidhur me cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor gjatë gjykimit të themelit të çështjes.

25. Në përfundim, vlerësoj se vendimmarrja e shumicës, në rastin konkret, është në shkelje të parimit të gjësë së gjykuar. Përfundimi i procesit gjyqësor penal në të gjitha shkallët e gjykimit i heq mundësinë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë për të marrë në shqyrtim rekursin kundër vendimit të dhënë më parë nga ky Kolegj, përveçse në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e vendimit. Në këtë kuptim, arsyetimi i Kolegji Penal për mungesën e shkaqeve të rekursit nuk përbën cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, dhe është në përputhje me unifikimin e praktikës gjyqësore.

26. Për rrjedhojë, mendoj se qëndrimi i shumicës për pranimin, qoftë edhe pjesërisht, të kërkesës dhe për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është haptazi i gabuar.

Anëtare: Vitore Tusha

## VENDIM

Nr. 59, datë 24.12.2012

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i		“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 22.11.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me bazë dokumentesh çështjen nr. 43 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Spiro Taba

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë, brenda afatit të arsyeshëm, nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f, 134/g dhe 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes, Vitore Tusha dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

1. Kërkuesi ka qenë nëpunës civil në pozicionin e inspektorit në Sektorin e Kontrollit në degën e tatim-taksave, Korçë, nga data 18.2.2000. Me vendimin nr. 523, datë 11.6.2007 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve (DPT) Tiranë, ai është liruar nga shërbimi civil për shkak të “ristrukturimit”, duke iu ndërprerë menjëherë marrëdhëniet e punës.

2. Ky akt është bërë objekt i shqyrtimit administrativ në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), por kërkesa ankimore e kërkuesit është rrëzuar me vendimin nr. 262, datë 11.12.2007 të KSHC-së.

3. Në datën 21.1.2008 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë duke kërkuar anulimin e vendimeve nr. 262, datë 11.12.2007 të KSHC-së, nr. 523, datë 11.6.2007 të DPT-së, dhe vazhdimin e marrëdhënieve financiare deri në rikthimin në vendin e punës. Gjykata e





Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1827, datë 07.07.2008, vendosi anulimin e vendimit të DPT-së, për lirimin nga shërbimi civil dhe kalimin në listën e pritjes së paditësit, anulimin e vendimit të KSHC-së, duke iu paguar paditësit paga deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës.

4. Kundër këtij vendimi paraqiti ankim DPT-ja, dhe Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 345, datë 3.12.2008, vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimet nr. 326, datë 22.1.2009, dhe nr. 1975, datë 22.4.2009, ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit të vendimit nr. 1827, datë 7.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, lënë në fuqi me vendimin nr. 345, datë 3.12.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 471, datë 1.3.2012, të marrë në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga DPT-ja.

7. Kërkuesi, për vënien në ekzekutim të vendimit gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm, i është drejtuar fillimisht Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë në datën 11.2.2009 duke i kërkuar ekzekutimin vullnetar të urdhërekzekutimit nr. 41-2009-326 (38) prot., datë 22.1.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Sipas kërkuesit, ai nuk mori asnjëherë përgjigje për këtë shkresë.

8. Në datat 3.5.2010 dhe 3.1.2011 kërkuesi ka paraqitur në DPT një shkresë ku në mënyrë analitike përcaktohet detyrimi financiar i saj ndaj kërkuesit deri në datën 30.4.2010. Sipas komunikimit zyrtar bashkëngjitur kërkesës, konkretisht shkresave të DPT-së nr. 7383/1, datë 27.5.2010; nr. 112/1, datë 15.2.2011; nr. 16800/1 prot., datë 14.9.2011, kërkuesi ka marrë përgjigje nga DPT-ja se: *“vetëm pas marrjes së vendimit të Gjykatës së Lartë, DPT-ja do të shqyrtojë kërkesën tuaj dhe do të ndjekë procedurat ligjore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor sipas dispozitivit të tij”*. Komunikimi me DPT-në ka vazhduar edhe pas marrjes së vendimit nr. 471, datë 1.3.2012, të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) për mospranimin e rekursit të paraqitur nga DPT-ja.

9. Me hyrjen në fuqi të shërbimit për përmbaruesit privatë, kërkuesi, në datën 1.11.2011, ka lidhur kontratë me shoqërinë përmbarimore private “KURMAKU” sh.p.k. (ZPP), e cila ka filluar menjëherë procedurat për vënien në ekzekutim të urdhrin të ekzekutimit përmes lajmërimit të palës debitore për ekzekutimin vullnetar dhe, më pas, për ekzekutimin e detyrueshëm të vendimit të formës së prerë. Po ashtu, ZPP-ja, në zbatim të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2001 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, i është drejtuar Zyrës së Thesarit Tiranë (shkresa për dijeni DPT-së) me urdhër për vendosjen e sekuestros konservative, urdhër i cili është vënë në zbatim.

10. Sipas parashtrimeve të kërkuesit nuk ka pasur asnjë reagim nga ana e palës debitore për përmbaruesin e urdhërimeve të vendimit gjyqësor të formës së prerë për kthimin në punë dhe pagimin e pagës, edhe pse ai i është drejtuar edhe institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

## II

11. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 5.9.2012, duke kërkuar, në thelb, konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 1827, datë 7.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, brenda afatit të arsyeshëm, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, si autoriteti i ngarkuar nga ligji me këtë detyrim. Konkretisht, kërkuesi pretendon se mosekzekutimi i vendimit të formës së prerë nr. 1827:

11.1 ka cenuar vlerat dhe të drejtën e personalitetit, pasi i kanë tronditur jetën e përditshme;

11.2 e ka privuar nga e drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit si financier, të zgjedhur lirisht prej tij;

11.3 e ka privuar nga e drejta e mbrojtjes shoqërore dhe shëndetësore;

11.4 i ka përkeqësuar gjëndjen sociale për shkak të kushteve të rënda ekonomike.

12. *Subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve* nuk ka paraqitur prapësime me shkrim.

### III

#### *A. Në lidhje me pretendimin për mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm*

13. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ekzekutimi, brenda një afati të arsyeshëm, i një vendimi të formës së prerë të gjykatës, duhet konsideruar si pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim vendimet gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2012; nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individit e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka rikonfirmuar në shumë vendime të saj qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 1.4.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Po ashtu, Gjykata, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme, ka rikonfirmuar se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen dhe interesin e aplikantit dhe sjelljen e autoriteteve përkatëse (*shih vendimet nr. 12, datë 15.4.2011; nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

#### *i) Periudha që duhet marrë në konsideratë*

17. Gjykata Kushtetuese, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, vlerëson se organet shtetërore duhet të përmbushin detyrimet që rrjedhin nga një vendim gjyqësor sapo vendimi të bëhet i ekzekutueshëm. Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të Kodit të Procedurës Civile vendimi i Gjykatës së Apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar (*shih vendimin nr. 43, datë 19.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në çështjen konkrete nuk rezulton që ekzekutimi i vendimit nr. 345, datë 3.12.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë të jetë pezulluar me vendim të Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky vendim është i ekzekutueshëm që në datën 3.12.2008, e cila është data e marrjes së tij. Duke qenë se deri në momentin e paraqitjes së kërkesës, si dhe të marrjes në shqyrtim të saj nuk ka ndonjë informacion për vënien në ekzekutim të titullit ekzekutiv, vendimit nr. 345, nga pala debitorë, DPT, Gjykata vlerëson se periudha e cila duhet të merret në konsideratë ka filluar në datën 03.12.2008 dhe vazhdon në mënyrë të pandërprerë.



*ii) Kompleksiteti i çështjes*

19. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 8, datë 23.3.2010, nr. 14, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykata konstaton se çështja në shqyrtim ka për objekt mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, për sa i përket kthimit në punë dhe pagimit të pjesës së mbetur të pagës. Në këtë kuptim, çështja konkrete nuk paraqet kompleksitet nga pikëpamja faktike ose ligjore, çka mund të justifikonte vonesat apo sjelljen mosvepruese të subjektit të interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë. Për sa kohë kjo çështje nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesve është me rëndësi në këtë kontekst.

*iii) Sjellja e kërkuesit*

21. Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se vlerësimi i sjelljes dhe i interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke nënvizuar se përdorimi nga ana e kërkuesit i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tij (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 14, datë 15.4.2010*).

22. Nga materialet e çështjes konstatohet se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, mbi kërkesën e kërkuesit, ka lëshuar urdhrat e ekzekutimit nr. 326, datë 22.1.2009 dhe nr. 1975, datë 22.4.2009 për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë nr. 1827, datë 7.7.2008. Kërkuesi i është drejtuar menjëherë palës debitore për ekzekutimin vullnetar të titullit ekzekutiv. Po ashtu konstatohet, se përmes ZPP "KURMAKU", kërkuesi i është drejtuar në mënyrë të përsëritur DPT-së për përmbushjen e urdhërimeve të dispozitivit të vendimit nr. 1827, konkretisht, kthimin në vendin e punës dhe pagimin e pagës.

23. Gjithashtu, kërkuesi i është drejtuar edhe institucionit të Avokatit të Popullit, i cili në datën 7.5.2012 i është drejtuar DPT-së me një rekomandim për marrjen e masave ligjore për ekzekutimin e detyrimeve të vendosura në titullin ekzekutiv, vendimin gjyqësor nr. 1827, datë 7.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Në përgjigje të këtij rekomandimi, DPT-ja, në datën 12.6.2012, informon se: "*po shihet mundësia e likuidimit pjesor për kreditorin Spiro Taba. Kurse, për sa i përket rikthimit në pozicionet e mëparshme të punës sqarojmë se aktualisht jemi në pamundësi ekzekutimi të vendimeve gjyqësore. Sapo të na krijohet mundësia do t'i ekzekutojmë*". Gjithashtu, Avokati i Popullit i është drejtuar Ministrit të Financave në datën 27.07.2012 me rekomandim për marrjen e nismës për fillimin e procedurës për dhënie mase disiplinore ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së.

24. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar. Nga tërësia e fakteve dhe rrethanave nuk rezulton që sjelljet e kërkuesit të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

*iv) Sjellja e autoriteteve*

25. Për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka theksuar se përballë detyrimit për zbatim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të gjitha subjektet, qofshin këto private apo publike, duhet të përgjigjen njëjloj. Gjykata ka nënvizuar vazhdimisht se në fazën e ekzekutimit të vendimeve marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë. Roli i këtyre organeve bëhet vendimtar, kur debitori refuzon të ekzekutojë vullnetarisht detyrimin e tij kundrejt kreditorit. Në raste të tilla, procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm

vendimmarrjen e gjykatave, por edhe mënyrën e kryerjes së veprimeve konkrete të organeve përgjegjëse, të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 6, datë 4.3.2010*). Autoritetet shtetërore nuk mund të përmendin mungesën e fondeve si justifikim për të mos respektuar një detyrim financiar që vjen nga një vendim gjyqësor. I takon debitorit të gjejë një mundësi zgjidhjeje sa më të përshtatshme me qëllim vënien në vend të së drejtës së kreditorit (*shih vendimet nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 2, datë 1.2.2011; nr. 1, datë 20.1.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa i përket sjelljes së Zyrës Përmbare Private “KURMAKU”, Gjykata konstaton se, në të njëjtën datë të lidhjes së kontratës me kërkuesin, ajo i është drejtuar DPT-së me shkresën nr. 123 akti për zbatimin vullnetar të titullit ekzekutiv, vendimit nr. 1827, datë 7.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke përcaktuar detyrimin financiar në total 3.305.209 lekë, shumë e cila konsiston në detyrimin financiar për periudhën 1.7.2008 deri më 31.10.2011 në masën 3.390.606 lekë, shpenzimet gjyqësore në masën 41.700 lekë; tarifën e subjektit përmbare në shumën 172.903 lekë. Në përgjigje të kësaj shkrese, DPT-ja në datën 15.11.2011 sqaron se “*për fillimin e procedurave të vënies në ekzekutim të titullit ekzekutiv, i nevojitet dokumentacioni i plotë i çështjes, përkatësisht dërgoni vendimin e Gjykatës së Lartë*”. Kjo kërkesë përsëritet nga DPT-ja edhe në shkresën nr. 21476/1 prot., datë 7.12.2011.

27. Në datën 8.11.2011, ZPP-ja, në kushtet e mosmarrjes së përgjigjes brenda afatit ligjor prej 5 ditësh nga DPT-ja, i është drejtuar kësaj të fundit me shkresën nr. 123 akti duke e vënë në dijeni se për likuidimin e shumës së mësipërme kanë filluar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të urdhër ekzekutimit nr. 41-2009-326, datë 22.1.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Ky detyrim përmendet edhe në shkresën e ZPP-së të datës 17.11.2011.

28. Në datën 14.11.2011, ZPP-ja në zbatim të udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 18.8.2011 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit” i është drejtuar Zyrës së Thesarit Tiranë (shkresa për dijeni DPT-së) me urdhër për vendosjen e sekuestros konservative për bllokimin e llogarisë bankare të subjektit debitor DPT Tiranë në shumën 3.305.209 lekë.

29. Në datën 18.1.2012 Dega e Thesarit Tiranë, duke mos marrë përgjigje për shkresën nr. 3143/2, datë 12.12.2011 drejtuar DPT-së, vendosi sekuestron konservative.

30. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se Zyra Private e Përmbaremit “KURMAKU” i ka kryer veprimet përmbare në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi dhe nuk rezulton që sjelljet e ZPP-së të jenë bërë shkak për mosekzekutimin e vendimit të formës së prerë.

31. Për sa i përket sjelljes së palës debitore, DPT Tiranë, Gjykata konstaton se ky institucion ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar detyrimin ndaj debitorit, nisur nga afatet kohore gjatë të cilave kërkuesi dhe ZPP-ja janë përpjekur të vënë në ekzekutim titullin ekzekutiv. Kanë kaluar më shumë se 3 vjet nga data që kanë dalë urdhërekzekutimet dhe ato ende nuk janë zbatuar. Edhe pse kërkuesi dhe ZPP-ja kanë vënë në dispozicion të DPT-së kopje të vendimit të Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit (të paraqitur nga vetë pala debitore), mungesa e të cilit ka qenë justifikimi i vazhdueshëm i DPT-së për mosekzekutimin e vendimit, përsëri kjo e fundit ende nuk ka përmbushur detyrimet sipas dispozitivit të vendimit gjyqësor nr. 1827, datë 7.7.2008. Ashtu siç rezulton edhe nga komunikimet zyrtare të Avokatit të Popullit me palën debitore, kjo e fundit nuk jep asnjë siguri konkrete se vendimi gjyqësor do të vihet në ekzekutim sipas urdhërimeve të dispozitivit.

32. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pala debitore, DPT, jo vetëm që nuk e ka përmbushur këtë detyrim ligjor, por nuk ka shfaqur vullnet dhe nuk ka kryer veprimet e duhura në plotësim të detyrimeve të saj për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.



33. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ndodhet përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja “f” dhe nenit 134, pika 1, shkronja “g” të Kushtetutës; neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me unanimitet:

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 1827, datë 7.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha

#### VENDIM

**Nr. 4, datë 27.12.2012**

#### **PËR PËRCAKTIMIN E RASTEVE PËR PËRJASHTIMET NGA DETYRIMI PËR NJOFTIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE, QË PËRPUNOHEN**

Mbështetur në pikën 4 të nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

#### VENDOSI:

1. Përcaktimin e rasteve, për të cilat njoftimi për përpunimin e të dhënave personale, pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk është i nevojshëm, si më poshtë vijon:

a) Kur përpunimi i këtyre të dhënave kryhet nga organizatat jofitimprurëse politike, sindikaliste, fetare ose filozofike, për qëllime të veprimtarisë së tyre të ligjshme, për anëtarët, sponsorizuesit ose personat e tjerë, që kanë lidhje të vazhdueshme me veprimtarinë e këtyre organizatave;

b) Kur përpunimi i këtyre të dhënave lidhet me menaxhimin e burimeve njerëzore në sektorin publik dhe privat, në ushtrimin e të drejtave e të detyrimeve, të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore, dalë në zbatim të tyre, nëse përpunimi kufizohet në:

- i) qëllimin e pranimit në punë;
- ii) aplikimet;
- iii) konkurrimet;
- iv) emërimet;
- v) largimet nga detyra;

- vi) ngritjet në detyrë;
- vii) vlerësimet e rezultateve të punës;
- viii) masat disiplinore;
- ix) regjistrin e personelit;
- x) kualifikimet;
- xi) të dhënat në kontratën e punës;
- xii) përlllogaritjet e pagave.

Të dhënat sensitive, që mund të përpunohen për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij vendimi, janë të detyrueshme të njoftohen.

c) Kur përpunimi i të dhënave bëhet në zbatim të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, por kufizohet në përmbushjen e qëllimeve të nevojshme, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Regjistrimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

**VENDIM**  
**Nr. 5, Datë 27.12.2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 2, DATË 10.3.2010 “PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIMIT TË TË DHËNAVE, TË HEDHJES SË TË DHËNAVE, TË PËRPUNIMIT DHE NXJERRJES SË TYRE”**

Mbështetur në pikën 6 të nenit 27 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar,

**VENDOSA:**

Në vendimin nr. 2, datë 10.3.2010 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

1. Pas titullit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shtohet togfjalëshi si vijon:  
“i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.”
2. Përmbajtja e shkronjës “a” të pikës 1 të kreut I, ndryshohet si më poshtë:  
“Të dhënat mund të mbahen vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime, dhe përpunimi i tyre duhet të bëhet vetëm mbi bazën e këtyre qëllimeve”.
3. Paragrafi “vi” i shkronjës “a” të pikës 4, në kreun I, shfuqizohet.
4. Titulli i pikës 6 të kreut I ndryshohet si vijon:  
“Transferimi ndërkombëtar i të dhënave”.
5. Në shkronjën “a” të pikës 6, të kreut I, fjala “tipi” zëvendësohet me fjalën “kategoria”.
6. Në përmbajtje të këtij vendimi, termi “subjekt kontrollues” zëvendësohet me termin “kontrollues”.
7. Në pikën 2 të kreut II, bëhen këto ndryshime:  
a) Përmbajtja e shkronjës “b” ndryshohet si vijon:



“Fushën dhe qëllimin për të cilin mbliidhen dhe do të përpunohen të dhënat personale”.

b) Shkronja “c” shfuqizohet.

c) Në shkronjën “d”, fjala “zbulohen” zëvendësohet me fjalën “përhapen”.

ç) Përmbajtja e shkronjës “e” ndryshohet si vijon:

“Të drejtën për askes, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij”.

d) Shkronjat “f”, “g” dhe “h” shfuqizohen.

dh) Në fund, shtohen shkronjat me përmbajtje si vijojnë:

- Mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni;

- Faktin nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare;

- Faktin nëse është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor;

- Pasojat e refuzimit të dhënies së të dhënave.

8. Përmbajtja e pikës 2 të kreut III, ndryshohet si vijon:

“Të dhënat mund të përpunohen pa pëlqimin e subjektit kur përpunimi është i nevojshëm për një nga arsyet e parashikuara në pikën 1 të nenit 6 të ligjit, me përjashtim të shkronjës “a”.”

9. Titulli i kreut V ndryshohet në “Konfidencialiteti i të dhënave” dhe përmbajtja e tij ndryshohet si vijon:

“Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat e punësuar prej tyre, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave personale që përpunojnë, në përputhje me detyrimet e parashikuara në nenin 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.”

10. Moszbatimi i kërkesave të këtij vendimi, përbën shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

## UDHËZIM

Nr. 24, datë 27.12.2012

### PËR DETYRIMET E KONTROLLUESVE PËRPARA SE TË PËRPUNOJNË TË DHËNAT PERSONALE

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

#### UDHËZON:

1. Të gjithë kontrolluesit publikë dhe privatë, përpara se të kryejnë përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar (këtej e tutje ligji), detyrohen:

a) të mbledhin të dhëna personale në përputhje me qëllimin;

b) të informojnë subjektin e të dhënave në përputhje me nenin 18 të ligjit;

c) të kryejnë njoftimin manualisht ose elektronikisht në përputhje me këtë ligj dhe formularin e njoftimit të miratuar nga komisioneri me urdhrin nr. 221, datë 27.12.2012;

ç) të plotësojnë në afat kërkesat e komisionerit për formularin e njoftimit, kur ai konsiderohet i paplotë. Nëse kontrolluesi nuk plotëson përmbajtjen e njoftimit brenda afatit të përcaktuar, njoftimi konsiderohet i pakryer dhe do të gjohet sipas shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 39 të ligjit;

d) të marrin masa teknike dhe organizative për ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në përputhje me këtë ligj dhe udhëzimet përkatëse;

dh) të paraqesin kërkesë për autorizim në rastin e përpunimit të të dhënave sensitive për një interes të rëndësishëm publik, duke parashikuar masa të përshtatshme mbrojtëse;

e) të paraqesin kërkesë për autorizim për transferimin ndërkombëtar të të dhënave personale në një shtet që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, në përputhje me formularin e transferimit të miratuar nga komisioneri (publikuar në faqen zyrtare).

Kontrolluesit përjashtohen nga ky detyrim në rastet e parashikuara në pikën 2 të nenit 8 të këtij ligji dhe vendimin e miratuar nga komisioneri nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”;

ë) të paraqesin kërkesë për autorizim, në raste të veçanta, për përdorimin e të dhënave personale për qëllime jo të përcaktuara në grumbullimin e tyre, duke respektuar parimet e nenit 5 të ligjit;

f) të kryejnë përpunimin e të dhënave sensitive me pëlqimin e dhënë me shkrim nga subjekti i të dhënave;

g) të caktojnë personin përgjegjës (të kontaktit), i cili kryen mbikëqyrjen e brendshme, të përmbushjes së detyrimeve për mbrojtjen e të dhënave personale nga ana e kontrolluesit;

h) të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit/detyrës.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.

3. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen të gjithë kontrolluesit publikë e privatë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

4. Udhëzimi nr. 2, datë 25.2.2010 “Për detyrimet e kontrolluesve dhe përpunuesve përpara se të përpunojnë të dhënat personale” shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

## UDHËZIM

Nr. 25, datë 27.12.2012

### **PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 6.9.2011 “PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË KUADËR TË SHËRBIMEVE HOTELIERE”**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar,

#### UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 10, datë 6.9.2011 “Për përpunimin e të dhënave personale në kuadër të shërbimeve hoteliere”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

I. Pas titullit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shtohen fjalët si vijojnë:





“i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012”.

II. Në pikën 1 të kreut II togfjalëshi “kërkohen dhe regjistrohen” ndryshohet në “mblidhen dhe përpunohen”.

III. Pika 2 e kreut II ndryshohet si vijon:

“Hoteli nuk duhet të përhapë ose të vendosë në dispozicion, të dhënat personale ndonjë pale të tretë pa pëlqimin e shprehur qartë me shkrim të klientit nëse qëllimi nuk ka lidhje me shërbimet e kërkuara prej tij.”

IV. Në pikën 3 të kreut II togfjalëshi “Deklaruar qartë” ndryshohet me togfjalëshin “shprehur qartë me shkrim”.

V. Në pikën 1 të kreut III fjala “mbledh” ndryshohet me fjalën “përpunojë”.

VI. Në pikën 4 të kreut III fjalia e parë ndryshon si vijon:

“Hoteli ruan të dhënat personale vetëm për një periudhë kohore që është e nevojshme me qëllim ofrimin e rezervimit të tij dhe strehimit apo shërbimeve të tjera të kërkuara.”

VII. Në paragrafin e kreut IV, fjala “qartësisht” ndryshohet me togfjalëshin “qartë me shkrim”.

VIII. Në aneksin 1 “Dhënia e pëlqimit për kopjimin e kartave personale të identitetit ose të dokumenteve të udhëtimit”, fjala “shpërndajë” ndryshohet me fjalën “përhapë”.

IX. Pas kreut IV shtohet një paragraf i ri me këtë përmbajtje:

“Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet sipas nenit 39 të tij”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

## UDHËZIM

Nr. 26, datë 27.12.2012

### PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 4, DATË 16.3.2010 “PËR MARRJEN E MASAVE TË SIGURISË SË TË DHËNAVE PERSONALE NË VEPRIMTARINË E FUSHËS SË ARSIMIT”

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012,

## UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 4, datë 16.3.2010 “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

1. Pas titullit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shtohen fjalët si vijojnë:

“i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.”

2. Pas pikës 10 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

10/1. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale kryhet me marrës, nga shtete me një nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale. Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendimin nr. 3, datë 19.11.2012 të komisionerit. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale me një shtet, që nuk ka nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale mund të bëhet në rastet e parashikuara në pikën 2 të nenit 8 të 10536

ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012 ose me autorizim të komisionerit sipas nenit 9, të ligjit të sipërpërmendur.

3. Fjalja e dytë e pikës 12, ndryshohet si vijon:

“Pëlqimi i subjekteve të të dhënave është deklarata me shkrim, e shfaqur me vullnet të qartë, të plotë e të lirë, çka nënkupton që subjekti i të dhënave është informuar për arsyen e përpunimit dhe pranon që të dhënat e tij të përpunohen.”

4. Pas pikës 14 shtohet një pikë me këtë përmbajtje:

“15. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

**UDHËZIM**  
**Nr. 27, datë 27.12.2012**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 7, DATË 9.6.2010 PËR  
PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE NË SEKTORIN E ARSIMIT**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 7, datë 9.6.2010 “Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e arsimit”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

1. Titulli i udhëzimit nr. 7, datë 9.6.2010 ndryshohet si vijon:

“Për përpunimin e të dhënave personale në institucionet e arsimit të lartë”.

2. Pas titullit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shtohen fjalët si vijojnë:

“i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.”

3. Fjalja e dytë e pikës 1 të kreut I, ndryshohet si vijon:

“Me përpunim të të dhënave personale do të kuptohet çdo veprim ose grup-veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja, ose ndryshe, duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një regjistër të dhënash.”

4. Fjalja e dytë e pikës 5 të kreut I, ndryshohet si vijon:

“Shtetet, që kanë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave, përcaktohen me vendimin nr. 3, datë 19.11.2012 të komisionerit.”

5. Në pikën 2 të kreut II, termi “kontrollorë të të dhënave” zëvendësohet me termin “kontrollues të të dhënave”.

6. Paragrafi i dytë i pikës 3, të kreut IV, zëvendësohet me paragrafin me këtë përmbajtje:

“Pëlqimi i subjekteve të të dhënave është deklarata me shkrim, e shfaqur me vullnet të qartë, të plotë e të lirë, çka nënkupton që subjekti i të dhënave është informuar për arsyen e përpunimit dhe pranon që të dhënat e tij të përpunohen.”



7. Pas pikës 6, të kreut IV shtohet një pikë me këtë përmbajtje:  
“7. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet sipas nenit 39 të tij”.  
Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

**UDHËZIM**  
Nr. 28, datë 27.12.2012

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 11, DATË 8.9.2011 “MBI PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE TË PUNONJËSVE NË SEKTORIN PRIVAT”**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 11, datë 8.9.2011 “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

1. Pas titullit të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, shtohen fjalët si vijojnë:  
“i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.”

2. Pika 9.4 ndryshohet si vijon:

“9.4 Të dhënat biometrike të mbledhura nuk mund të mbahen për një kohë më shumë nga sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimet për të cilat të dhënat janë mbledhur. Ky afat kohor mund të jetë ligjërisht i zgjatur, por në çdo rast duhet të sigurohen mekanizmat e duhur të fshirjes automatike së të dhënave.”

3. Pika 11.2 ndryshohet si vijon:

“11.2 Periudha e mbajtjes së të dhënave në një sistem vëzhgimi me kamera përcaktohet sipas shkronjës “c” të pikës 4 të udhëzimit nr. 13, datë 22.12.2011 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 5.3.2010 “Mbi sistemin e videosurvejimit në ndërtesa, lokale e ambiente të ndryshme”, miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

4. Pas pikës 15.2 shtohet një pikë e re me këtë përmbajtje:

“16. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

**UDHËZIM**  
**Nr. 29, datë 27.12.2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 26.12.2011 “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË TREGTIMIN E DREJTPËRDREJTË DHE MASAT E SIGURISË”**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 të shkronjës “ç” dhe “f” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 16, datë 26.12.2011 “Për mbrojtjen e të dhënave personale në tregtimin e drejtpërdrejtë dhe masat e sigurisë”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijon:

1. Pas titullit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” shtohen fjalët si vijojnë:

“i ndryshuar me ligjin nr. 48/2012.”

2. Termat e përkufizuar në udhëzim hiqen dhe shtohet fjalia si vijojnë:

“Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me atë të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.”

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KOMISIONERE**  
**Flora Çabej (Pogaçe)**

**UDHËZIM**  
**Nr. 30, datë 27.12.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.8.2012 “MBI RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE MES KONTROLLUESIT DHE PËRPUNUESIT NË RASTET E DELEGIMIT TË PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE DHE PËRDORIMIN E NJË KONTRATE TIP NË RASTET E KËTIJ DELEGIMI”**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, me ligjin nr. 48/2012,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 19, datë 3.8.2012 “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Fjalia e fundit e shkronjës “c”, e pikës 5 ndryshohet si vijon:

“Kontrolluesi duhet t’i referohet listës së vendeve që ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme të miratuar me vendimin nr. 3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të Mbrojtjes së të Dhënave Personale” dhe aneksit 1 bashkëlidhur, miratuar nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.”



Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

**UDHËZIM**  
**Nr. 31, datë 27.12.2012**

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR PËRJASHTIMIN NGA  
DETYRIMET PËRKATËSE NË PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR  
QËLLIME GAZETARIE, LETRARE OSE ARTISTIKE**

Mbështetur në nenin 11, në shkronjën “c”, pika 1 e nenit 30 dhe shkronjën “f” pika 1 e nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

**UDHËZON:**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky udhëzim përcakton kushtet në bazë të të cilave përpunimi i të dhënave personale mund të përjashtohet nga detyrimet që parashikohen në nenet 5, 6, 7, 8, 18 dhe 21 të ligjit, me qëllim balancimin e së drejtës së individëve për të mbrojtur të dhënat e tyre personale me rregullat e zbatueshme për të drejtën e lirisë së shprehjes.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

Ky udhëzim zbatohet për çdo kontrollues/person fizik ose juridik që përpunon të dhëna personale për qëllime gazetarie, letrare ose artistike.

**Neni 3**  
**Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në nenin 2 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Gjithashtu, në këtë udhëzim:

- a) “Ligj” nënkupton ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.
- b) “Publikim” përfshin edhe dhënien nga një person të një tjetër të një materiali për t’u botuar nga ky i fundit.
- c) “Detyrimet përkatëse” nënkupton detyrimet që parashikohen në nenet 5, 6, 7, 8, 18 dhe 21 të ligjit.

**Neni 4**  
**Kushtet dhe kriteret për përjashtime**

1. Përpunimi i të dhënave personale përjashtohet nga çdo detyrim përkatës kur:
  - a) kontrolluesi ka si qëllim të botojë materiale gazetarie, letrare ose artistike, për përgatitjen e të cilave janë të nevojshme të dhëna personale në fjalë; dhe

b) publikimi i materialit është në interes të publikut; dhe  
c) përmbushja e atij detyrimi bie në kundërshtim me qëllimin letrar, artistik apo të gazetarisë të synuar.

2. Nëse kontrolluesi mund të përmbushë një nga detyrimet përkatëse, pa u mbështetur në përjashtimet e pikës 1, ai duhet ta përmbushë atë.

3. Kur kontrolluesi mbështetet në përjashtimet e nenit 11 të ligjit, ai i mban të dhënat personale vetëm për atë kohë sa i duhet të botojë materiale gazetarie, letrare ose artistike, për përgatitjen e të cilave nevojiten të dhënat personale.

4. Kur kontrolluesi mbështetet në përjashtimet e nenit 11 të ligjit, ai nuk përhap të dhënat personale të çdo person tjetër, përveçse:

- a) në formën e materialit të gazetarisë, letrar ose artistik të botuar; ose
- b) të marrës të cilët e ndihmojnë atë në përgatitjen e materialit letrar, artistik ose të gazetarisë, material të cilin ai synon ta publikojë; ose
- c) të marrës që janë botuesit e mundshëm të atij materiali; ose
- ç) të Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; ose
- d) të një gjykatë.

5. Kur kontrolluesi mbështetet në përjashtimet e nenit 11 të ligjit, ai nuk i përpunon të dhënat personale për asnjë qëllim tjetër përveç qëllimit të gazetarisë, letrar ose artistik.

6. Kur botohet një material gazetarie, letrar ose artistik, i cili është përgatitur duke u mbështetur në përjashtimet e nenit 11 të ligjit, ai nuk duhet të përmbajë informacione mbi bazën e të cilave mund të identifikohet një minoren, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, me përjashtim të rasteve kur është marrë:

- a) pëlqimi i prindit ose i kujdestarit ligjor të të miturit; ose
- b) leje nga gjykata.

7. Kur botohet një material gazetarie, letrar ose artistik, i cili është përgatitur duke u mbështetur në përjashtimet e nenit 11 të ligjit, ai nuk duhet të përmbajë informacione mbi bazën e të cilave mund të identifikohet viktimë ose personi i cili pretendon se është dëmtuar nga kryerja e një vepre penale, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi, me përjashtim kur:

- a) është marrë pëlqimi i viktimës ose i personit i cili pretendon se është dëmtuar nga kryerja e një vepre penale; ose
- b) është marrë leje nga gjykata; ose
- c) viktimë është figurë publike dhe veprimi që e bën atë viktimë ka lidhje me funksionin e tij publik.

8. Pa cenuar efektet e përgjithshme të pikave 6 dhe 7 të këtij neni, kur botohet një material gazetarie, letrar ose artistik, i cili është përgatitur duke u mbështetur në përjashtimet e nenit 11 të ligjit dhe që përmban imazhe të të miturve ose të viktimave të një vepre penale apo personave që pretendojnë se janë dëmtuar nga një vepër penale, duhet të përdoren mjete të duhura efektive për të fshehur identitetin e individëve në fjalë. Në veçanti, e tërë fytyra e individit dhe e ndonjë të afërmi apo të ndonjë bashkëpunëtor të ngushtë të njohur të individit, nëse ato shfaqen në të njëjtin imazh ose në një imazh të veçantë që botohet njëkohësisht, duhet të errësohen ose ndryshe të bëhen të paidentifikueshëm.

## Neni 5 Të fundit

1. Janë përgjegjës për zbatimin e këtij udhëzimi të gjithë kontrolluesit e parashikuar në nenin 2 të këtij udhëzimi.

2. Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet sipas nenit 39 të tij.



3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

**UDHËZIM**  
**Nr. 32, datë 27.12.2012**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 9, DATË 15.9.2010 “PËR RREGULLAT THEMELORE NË LIDHJE ME MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE NË MEDIAN E SHKRUAR, VIZIVE DHE AUDIOVIZIVE”**

Në mbështetje të shkronjës “c” të pikës 1 të nenit 30 dhe të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 31 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar,

**UDHËZOJ:**

Në udhëzimin nr. 9, datë 15.9.2010 “Për rregullat themelore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në median e shkruar, vizive dhe audiovizive”, bëhen shtesa dhe ndryshimet si vijojnë:

1. Pas titullit të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” shtohet togfjalëshi “të ndryshuar”.

2. Në kreun I, përmbajtja e pikës 1 ndryshohet si vijon:

a) Fjalja e parë ndryshohet si vijon:

“Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për të gjithë kontrolluesit publikë dhe privatë, të medias së shkruar, vizive dhe audiovizive në përpunimin e të dhënave personale të shtetasve.”

b) Shkronjat “a”, “b”, dhe “c” hiqen.

3. Në kreun I, përmbajtja e pikës 2 ndryshohet si vijon:

“Kushdo që përpunon të dhëna personale vetëm për qëllime gazetarie, letrare ose artistike, së pari respekton të drejtën e individit për të mbrojtur të dhënat personale të tij.”

4. Në përmbajtje të udhëzimit termi “fëmijët” zëvendësohet me termin “të miturit”.

5. Në kreun VII, përmbajtja e pikës 1 ndryshohet si vijon:

“Të dhënat sensitive mund të përpunohen nga gazetarët vetëm kur kanë marrë pëlqimin nga subjektet, të cilat mund të revokohen në çdo çast.”

6. Në kreun IX, përmbajtja e pikës 2 hiqet.

7. Në kreun X, përmbajtja e pikës 2 ndryshohet si vijon:

“Moszbatimi i kërkesave të këtij udhëzimi, përbën shkelje të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERE  
Flora Çabej (Pogaçe)

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QBZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 3.1.2013

Doli nga shtypi më 4.1.2013

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2013

Çmimi 60 lekë